



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 29 (827884)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 26 korrik 2024

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Sot, Ju jeni gardianë të sovranitetit dhe integritetit të Atdheut



» faqe 4

Qendra MADM në Forcën Tokësore modernizohet me sisteme të reja dekontaminimi

Në mjediset e MADM, në Forcën Tokësore, u bë dorëzimi dhe trajnimi me sistemet e reja të dekontaminimit, katër sisteme të mekanizuar dhe gjashtë sisteme stacionare, pjesë e modernizimit të QMADM, do të bëjnë të mundur përmbushjen e plotë të misionit që ka kjo qendër.

Trajnimi i efektivit të MADM-së, për njohjen dhe përdorimin e pajisjeve të reja u bë nga specialistë italianë të firmës “Cristanini”, të cilët u fokusuan në përgatitjen për punë të sistemit të dekontaminimit të personelit, teknikës, pajimeve, terrenit dhe pikave kyçe të tij. Me këto sisteme priten të realizohen detyra, të cilat nuk mund të realizoheshin më parë.



Batalioni Komando përfundoi me sukses stërvitjen ujore “Pashalimani 24/2” në rajonin e Distriktit Detar Jugor

Batalioni Komando përfundoi me sukses stërvitjen ujore “Pashalimani 24/2” në rajonin e Distriktit Detar Jugor të Pashalimanit - Vlorë. Qëllimi i kësaj stërvitje ishte testimi i aftësive planëzuese dhe kapaciteteve operacionale të trupave Komando në kuadër të përmbushjes së misionit dhe LDTHM së bKOM. Kjo stërvitje konsistoi në zhvillimin e trajnimit të trupave pjesëmarrëse në kushte të temperaturave të larta të motit dhe në terrene ujore, kryerja e operacioneve, goditje objekti dhe bordingu në anije nëpërmjet ndërthurjes së platformave ujore dhe tokësore, si dhe trajnimi dhe testimi i trupave komando në elementë të ndryshëm të notit, rritjes së rezistencës në ujë si dhe marrjes së njohurive bazë për pajisjet e zhytjes.

Në këtë stërvitje marrin pjesë rreth 120 trupa komando dhe 13 mjete. Stërvitja “Pashalimani 24/2” u inspektua personalisht nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, i cili përgëzoi komandantin e Batalionit Komando nënkolonel Hidrin, si dhe efektivët pjesëmarrës, për zhvillimin kësaj stërvitje me disiplinë, përkushtim dhe për seriozitetin e treguar në realizimin e çdo detyre të ngarkuar.



Komandanti i KMS-së, gjeneral brigade Ylli Pulaj priti Atasheu Ushtarak të Rumanisë, kolonel Valerica Piroška

Atasheu Ushtarak i Rumanisë, kolonel Valerica Piroška me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë, zhvilloi vizitë korteze në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Ai u prit nga Komandanti i Kolegjit, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili e falënderoi për vizitën dhe shprehu mirënjohje për kontributin e tij gjatë qëndrimit në Shqipëri, si urë koordinimi me rëndësi mes institucioneve të edukimit ushtarak.

Kolonel Piroška, duke falënderuar gjeneral brigade Ylli Pulajn për pritjen, tha se po largohet me përshtypjet më të mira nga njësitë e Forcave të Armatosura Shqiptare dhe se bashkëpunimet në fushën e arsimit (trajnime dhe kurse) do të vijojnë në të ardhmen.

Finalizohet me sukses operacioni SAR nga anija në mision “Oriku”

Anija P-133 “Oriku”, pjesë e misionit në Detin Egje, gjatë patrullimit në koordinim me Rojën Bregdetare greke, finalizuan me sukses operacionin e kërkim-shpëtimit.


Operacioni u zhvillua për t'i dhënë ndihmë emigrantëve të paligjshëm, të cilët lundronin në kushte të vështira dhe rrezikonin të mbyteshin. Pas koordinimit të anijes “Oriku”, me Rojën Bregdetare greke u bë i mundur shpëtimi i 20 emigrantëve me kombësi nga Palestina, 16 meshkuj, 3 femra, 1 fëmijë. Emigrantët e shpëtuar ndodhen në gjendje të mirë shëndetësore dhe u morën nga Roja Bregdetare greke për vazhdimin e procedurave të mëtejshme. Forca Detare / Roja Bregdetare vazhdon misionin e saj fisnik në shpëtimin e jetëve njerëzore, në kuadër të Aleancës.



U zhvillua takimi ndërmjet shtabeve të FD/RB së Shqipërisë dhe FD Malit të Zi

Në kuadër të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh me Malin e Zi, në Komandën e Forcës Detare/Rojës Bregdetare, u zhvillua raundi i dytë i takimeve midis Shtabeve të Forcës Detare shqiptare dhe asaj të Malit të Zi.

Komandanti i FD/RB, kundëradmiral Adnand Agastra, pas pritjes së komandantit të Forcës Detare të Malit të Zi, kapiten i rangut II Milan Jevtović dhe delegacionit të tij, falënderoi për bashkëpunimin midis Forcave Detare të dy vendeve si dhe shprehu dëshirën dhe angazhimin e FD-së për zhvillimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi si dy vende fqinje dhe aleatë të NATO. Kapiten i rangut II Jevtović shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij për shkëmbimin e eksperiencës së FD/RB shqiptare në përgatitjen e personelit



dhe anijeve për pjesëmarrje në misionet e drejtuara nga NATO në detin Mesdhe dhe detin Egje. Kapiteni shprehu gjithashtu interesin për mundësinë e imbarkimit të personelit të Malit të Zi në anijet e FD/RB,

pjesëmarrëse në mision. Aktiviteti vazhdoi me diskutimet ndërmjet përfaqësuesve të Shtabeve të Forcës Detare të Shqipërisë dhe Malit të Zi, për procesin e planëzimit dhe dislokimit të anijeve në misione.



Në sheshin “Italia”, aty ku para 30 vitesh të rinj dhe të reja shqiptare protestonin për liri, demokraci e arsimim europian, sot pasardhësit e tyre kremtojnë përmbylljen e ciklit të tyre universitar me standardet europiane dhe të barabartë, si moshatarët e tyre kudo në Europën e civilizuar. Një tjetër vlerë dhe kuptim merr kjo ceremoni, nga të rinjtë dhe të rejat e FA-së, të cilët nga nesër do të nisin një udhëtim të ri, të bukur dhe sfidues, atë të oficerit të ushtrisë shqiptare. Pjesë e kësaj ceremonie të veçantë, jo vetëm për studentët, familjarët e tyre, stafit akademik, komanduesit, ishin edhe qytetarë e kalimtarë të rastit, të cilët në përshtypjet e tyre u ndien të befásuar dhe njëkohësisht optimistë për të ardhmen e sigurisë së vendit tonë. Në këtë ceremoni morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, zëvendësministria e Arsimit Ana Kapaj, ambasadori i Republikës së Kosovës, Sh. T. z. Skënder Durmishi, gjeneralë, atashe, drejtorë e familjarë. Fjalën e hapjes së kësaj dite të veçantë për studentët e AFA-së, e mbajti komandanti i Akademisë, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, i cili do të theksonte:

“Sot është dita juaj! Ndaj ne jemi mbledhur këtu për të nderuar punën, arritjet, përkushtimin e sakrificat tuaja, të cilat kanë bërë të mundur mbërritjen e këtij momenti të shumëpritur, duke hapur dyert e karrierës tuaj ushtarake.

Gjatë këtij udhëtimi, keni kaluar mjaft sfida, si në anën intelektuale, fizike, ashtu edhe psikologjike, por ju ia dolët më së miri! Ky ishte testi dhe misioni juaj, të cilin ju e përbushët me sukses.

Prandaj, ne jemi besimplotë se ju sot jeni gati, pasi Akademia e Forcave të Armatosura, përfaqëson një institucion unik të arsimit të lartë. Ajo ka qenë dhe mbetet mbartëse dhe reflektuese e moralit, vlerave dhe frymës atdhetare e patriotike të vendit tonë, zëdhënëse e traditave të pasura të Forcave të Armatosura, qendër e rëndësishme e formimit intelektual, e mendimit shkencor, kulturës dhe historisë ushtarake, me mision të saj kryesor arsimimin e përgatitjen e brezit të ri të ushtarakëve për t'i shërbyer atdheut në çdo kohë dhe situatë.

Ndaj sot, përshëndes ju e të gjithë gjeneratat e studentëve, të pedagogëve, punonjësve dhe drejtuesve që kanë studiuar dhe shërbyer në këtë akademi, për kontributin e veçantë në arsimimin, përgatitjen dhe formimin e mijëra oficerëve për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura, por edhe përtej tyre”, - kështu do ta hapte fjalën e rastit komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj në ditën e diplomimit të oficerëve të rinj, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave të Armatosura.

“Akademia e Forcave të Armatosura tashmë vijon një proces të thellë transformimi, duke iu qasur modeleve më të mira dhe duke i dhënë



Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Sot, Ju jeni gardianë të sovranitetit dhe integritetit të Atdheut



asaj frymën, formën e përbajtjen e Akademisë së “West Point-it”. Ky transformim përfshin çdo aspekt të punës që nga modernizimi i kurrikulës, hapja e programeve të tjera, rritjen cilësore të trupës akademike dhe motivimi i saj.

Gjenerata e re që do të ndjekë studimet në AFA, do të ketë fatin që të kryejë studimet në një prej kampuseve më modernë të arsimit të lartë në vend, falë një investimi serioz nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes. Ndaj, sot gjej rastin të falënderoj Ministrin e Mbrojtjes, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, për mbështetjen që i kanë dhënë dhe vazhdojnë t'i japin Akademisë së Forcave të Armatosura, si një prioritet i veçantë për përgatitjen e oficerit të ri. Të dashur studentë, nëntogerë të rinj, përreth jush do të gjeni ata që kanë besuar dhe besojnë tek ju, dhe e kanë bërë këtë udhëtim jo vetëm të përballueshëm, por edhe të këndshëm: pedagogë e komandantë që ju kanë hapur horizonte të reja, shokë e shoqe klase që janë bërë tashmë familja juaj dhe sigurisht, të dashurit tuaj, mbështetja e të cilëve ka qenë pjesë e pandarë në mozaikun e suksesit tuaj.

Kjo gjeneratë që diplomohet mbart edhe një

simbolikë shumë të veçantë, pasi sot diplomohen gjithashtu për herë të parë edhe katër studentë nga Republika e Kosovës, të cilët përfunduan ciklin e plotë të studimeve në AFA. Motivimi, performanca dhe rezultatet e tyre kanë shërbyer si burim frymëzimi për të gjithë ne. Shpreh bindjen e plotë se ky shembull do vazhdojë edhe me brezat e tjerë në vijim.

Në karrierën tuaj, ju do të udhëhiqeni nga vlerat morale më të larta të përkushtimit ndaj Nderit, Detyrës e Atdheut, vlera të cilat do t'i mbani e zhvillonin me kujdes e do të shërbejnë si busull orientuese për të ardhmen.

Sot, ju jeni më të guximshëm nga sa besoni, më të fortë nga sa dukeni, e më të zgjuar nga sa mendoni. Ky kapitull i ri përbën të ardhmen e karrierës tuaj. Ishte privilegj dhe krenari e veçantë të shërbeja si komandanti juaj!”, - mbylli fjalën e rastit gjeneral brigade Nuredinaj.

Më tej, ministri i mbrojtjes Niko Peleshi, mes emocioneve të kësaj dite të veçantë do të shprehë: “Pas një rrugë të gjatë e të vështirë, ju arritët të realizoni sfidat e kadetit, duke hapur një kapitull të ri në jetën tuaj si oficer i Forcave të Armatosura.

Mes sfidave dhe stërvitjeve të pazakonshme për moshatarët tuaj, ju keni mundur t'ia dilni. Zgjedhja juaj ishte e vështirë por me një arsye dhe motiv të lartë për t'u bërë krenarë për të mbajtur mbi shpatulla uniformën ushtarake. Për ju “Nderi, Atdheu, Detyra” tanimë është motoja e jetës tuaj. Ju sot po filloni karrierën më dinjitoze si nënoficer i FA-së, përkrah pedagogëve dhe komanduesve tuaj dje, sot si kolegë. Udhëtimi juaj i ri, një udhëtim frymëzues për brezat që do të vijnë”.

Më tej ministri i Mbrojtjes tha se konsolidimi dhe reformimi i arsimit të Akademisë së Forcave të Armatosura ka qenë dhe do të mbetet një prioritet kryesor, në partneritet me Akademinë Ushtarake të SHBA-ve “West Point” dhe Gardën Kombëtare të New Jersey-it. “Akademia jonë është bërë sot një ofertë serioze për të gjithë të rinjtë e të rejat, të cilët kanë shprehur interesin nëpërmjet numrit të lartë të aplikimeve”. Në fund të ceremonisë studentët morën në duart e tyre konkludimin e punës trevjeçare, diplomat të cilat u dorëzuan nga lideri politik dhe ata ushtarakë dhe në fund, fishekzjarrët dhe ovacionet e tyre përmbyllën këtë natë magjike të jetës së tyre të re.





Nga 11 vatra zjarri të evidentuara në territorin e vendit gjatë 48 orëve të fundit, 7 prej tyre janë shuar, ndërsa 4 janë aktive.

Sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, vijon puna për shuarjen e zjarrit të rënë në fshatin Kakodhiq në bashkinë e Delvinës, i cili ndihmuar edhe nga temperaturat e larta dhe era, flakët përparuan në drejtim të fshatrave Dervican dhe Goranxi në Dropull të Poshtëm. Në ndihmë të strukturave operacionale të pushtetit vendor, për shuarjen e zjarrit janë bashkuar dhe 25 efektivë të Forcave të Armatosura.

21 vatra zjarri janë regjistruar në 24 orët e fundit, në territorin e vendit, nga të cilat 18 janë shuar falë përpjekjeve të vazhdueshme të qindra forcave operacionale, që po punojnë në terren në këto temperatura të larta. Sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, 3 vatra zjarri janë ende aktive.

Efektivët e Forcave të Armatosura e të Forcave Zjarrfikëse, së bashku me ato të Shërbimit Pyjor, po punojnë për izolimin e plotë të vatrës në fshatin Pregjë - Lurë, në Dibër.

Puna ka vazhduar për shuarjen e zjarrit të rënë në fshatin Shënmëri të bashkisë Mirditë, si dhe në vatrën e zjarrit midis fshatrave Goranxi dhe Dervican, në Dropull të Poshtëm. Për shkak të temperaturave, terrenit të vështirë dhe erës së fortë, zjarri dje në këtë zonë mori përmasa të mëdha duke përkeqësuar situatën në fshatrat Dhuvjan, Goranxi dhe Dervican.

Forcat e Armatosura janë përherë në gatishmëri për të ndihmuar në shuarjen e zjarreve, sa herë kërkohet ndërhyrja e tyre.

Ju lutemi banorëve të bashkëpunojnë me autoritetet vendore, duke raportuar në kohë vatrat e zjarrit, për të shmangur përhapjen në sipërfaqe më të gjera!

Forcat e Armatosura dhe Emergjencat Civile, në gatishmëri për shuarjen e zjarreve



Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile njofton se 2 vatra zjarri mbeten ende aktive.

Problematike është situata në fshatin Zogaj, bashkia Tropojë, ku terreni i vështirë ka penguar punën, duke bërë që zjarri i rënë në një sipërfaqe me shkurre dhe ferra të riaktivizohet. Operacioni vijon me forcat dhe mjetet e bashkisë Tropojë dhe Has.

Vijon operacioni për shuarjen e zjarrit në fshatin Malecaj, bashkia Lezhë. 50 efektivë të FA-së i janë bashkuar operacionit në këtë zonë, duke shmangur rrezikun ndaj shtëpive të fshatit.

Mirënjohje të gjithë efektivëve për punën dhe sakrificën që bëjnë çdo ditë në shërbim të komunitetit!



Në mbështetje të të gjithë forcave të angazhuara për shuarjen e zjarreve në disa zona të vendit dhe në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, forcat zjarrfikëse dhe bashkitë e komunat e zonave të prekura nga zjarri, për të gjithë periudhën që nga fillimi, është mundësuar dërgimi i helikopterit Cougar.

Kanë qenë 30 vetë, pilotë, teknikë helikopteri, kontrollorë, personel i shërbimeve mbështetëse, të cilët janë angazhuar për çdo fluturim, për të siguruar kushtet dhe parametrat e duhura për fluturim të helikopterit, si dhe për izolimin e plotë të vatrave të zjarrit në zonat Dhërmi, Gjirokastër, Dropull, Ulzë, Klos, Lurë.

Pavarësisht erërave të forta, të cilat në disa zona kanë vështirësuar aksionin për shuarjen e zjarreve, gatishmëria, angazhimi dhe bashkëpunimi i personelit të Forcës Ajrore nuk ka munguar, duke realizuar 12 misione me 34 orë fluturimi dhe hedhur rreth 360 kova ujë.

Angazhimi i Forcës Ajrore në situatën e zjarreve





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Dhe historia vazhdon....!

Para pak ditësh u raportua një ngjarje e rëndë, ku një 27 vjeçare tentoi të vetë-mbytej në lumin e Bunës, bashkë me 4 fëmijët e saj të mitur.

Divorci nga bashkëshorti, pamundësitë ekonomike, por edhe gjendja e rënduar psikologjike, e çuan të renë në tentativë të ndërmerre aktin e rëndë, duke sjellë në vëmendje një histori që tronditi para pak kohësh po Shkodrën, ku një tjetër grua e re, e lodhur, e sfilatur nga vështirësitë që po përballej dhe tradhtia e bashkëshortit u mbyt bashkë me 3 fëmijët e saj të mitur.

Fatmirësisht ngjarja e para pak ditëve u parandalua, por ngriti alarmin se ato mund të ripërsëriten.

Çfarë e shtyn një nënë të shkojë drejt vetëvrasjes, dhe pjesë të këtij akti fatal bën dhe fëmijët e saj?

Këto situata na bëjnë të kuptojmë se jeta e humbet qëllimin e saj nëse kombinimi i faktorëve emocionalë, psikologjikë, socialë dhe ekonomikë krijon kushtet e dëshpërimit dhe uljes së dëshirës për të jetuar. Ndërkohë ndalet edhe në rolin e medias, ku shpesh herë analizimi i sjelljeve të njerëzve që janë në një gjendje emocionale të rënduar, mund të ndikojë negativisht.

Grua në moshë të re, e divorcuar dhe braktisur nga bashkëshorti, me katër fëmijë, vështirësi ekonomike dhe elemente të tjera jetësore na risjellin në vëmendje nevojën urgjente, për të ndihmuar gratë që janë nëna të vetme. Kjo është një nga shenjat më të dukshme që na tregojnë se shoqëria ka nevojë të mbështesë institucionalisht nëpërmjet programeve të ndryshme sociale, ekonomike dhe psikologjike gratë që janë të divorcuara dhe me fëmijë.

Ajo që mund të kthehej në tragjedi në Shkodër, u parandalua falë policisë, por edhe familjarëve të saj, të cilët e kishin kuptuar se 27-vjeçarja po ikte në një rrugë pa kthim.

Dhuna ndaj grave, një trend në rritje

Shkalla e dhunës ndaj grave në familje: “Thonë që në Shqipëri një në tre gra rrihet nga burri, në Shkodër kanë një shprehje të dhimbshme por pjesë të realitetit ‘në tre gra rrihen dy e gjysmë’”.

Në Shqipëri, ashtu si edhe në shoqëri të tjera, në martesat tradicionale gruaja jepet në martesë nga i ati dhe merret (në disa raste në kuptimin e plotë të fjalës) nga familja e bashkëshortit me të cilën ajo do të jetojë.

Autoriteti i të atit mbi të si dhe përgjegjësia e tij për ta mbrojtur “nderin” e familjes, i kalojnë të shoqit.

Martestat mund të stisen, apo në disa raste gruaja mund edhe të detyrohet me forcë të martohet, nga i ati apo të vëllezërit.

Gratë rriten duke u mësuar të pranojnë se burrat janë më të fortë dhe më “të mençur” se ato.

Ato shikojnë se shteti favorizon burrat, pozicionet e pushtetit i zënë burrat, dhe kjo pasqyrohet kudo, në punësim, socializim, vendimmarrje.

Kështu pra, nuk është e çuditshme pse

Vetëvrasja e grave, fenomen apo “trend”?



shumë gra nuk e kuptojnë konceptin e dhunës në familje si vepër penale, ato kanë parë nënat e tyre të rrihen, dhe mendojnë se është normale të rrihesh, apo të të bërtasë burri apo kunati, dhe mendojnë se është e drejta e burrit që t'i rrahë.

E pra jemi në shekullin e 21-të, ku mendojmë se duke ecur me shpejtësinë e erës zhvillimi dhe teknologjia, arsimit dhe dija do ndryshonte dhe këto fenomene të shoqërisë, të cilat shekujt na i kanë lënë si gangrenë dhe nuk po e largojmë këtë virus infektues të shoqërive jo vetëm në Shqipëri por kudo ku injoranca dhe padituria bashkëjetojnë me humanët.

Vajzë, bijë, bashkëshorte, nënë

Ajo e pëson dhunën pikërisht në vendin që duhet të ishte më i sigurt për të dhe nga individ që duhet ta siguronte më shumë, pra nga bashkëshorti në banesë. Dhuna ndaj saj në fakt është skllavërim dhe ky skllavërim është një proces, i cili ka filluar për të që më parë dhe jo thjesht kur shoqërohet me dhunë.

Dhuna fizike është kulmi i një marrëdhënieje të shtrembëruar, që ka filluar që nga koha kur ajo ka qenë në familjen e saj. Që një grua të ketë kurajën për të luftuar dhunën e bashkëshortit, bashkëjetuesit apo partnerit, duhet në radhë të parë të jetë e lirë dhe sidomos e zhveshur nga nevoja. Gjithmonë është nevoja, ajo që e detyron gruan shqiptare të durojë dhunën familjare, një nevojë kjo sidomos me natyrë ekonomike. Dhe kur një individ vepron nën shtrëngimin e nevojës, ai nuk është më individ i lirë. Dhe gruaja shqiptare pavarësisht nga propaganda hipokrite e femrave politike dhe e të tjerave si ato që e kanë të zgjidhur çdo problem ekonomik,

mbetet individ me mungesën më të madhe të lirisë në shoqërinë shqiptare.

Më konkretisht: Nëse në Shqipëri shihet me vëmendje e drejta e pronës, megjithëse bëhet fjalë për një legjislacion modern, ai zbehet dhe zhvishet në themelet e tij për shkak të së drejtës zakonore, e cila funksionin si një ligj paralel me atë administrative, dhuna më e madhe ndaj gruas shqiptare fillon pikërisht te pasuria. Mungesa e saj e ndrydh atë në vetvete dhe e mban në kufijtë e skllavërisë dhe nuk e ndihmon të ndërtojë jetën e pavarur. Por dhuna ekonomike nuk përfundon këtu. Të zhveshura nga prona, vajzat e familjeve patriarkale shkojnë te bashkëshorti i ardhshëm, i cili ka probabilitet shumë më të madh për të pasur mirëqenie ekonomike krahasuar me të. Kur vjen momenti për një divorc të mundshëm, çfarë ndodh?

Të shtrenguara nga bashkëshortët e tyre, janë të shumta gratë të cilat heqin dorë nga pasuria e përfutur nga martesat. Dhe kur Dhoma Kombëtare e Noterëve konstaton se 95 për qind e tokës bujqësore është e regjistruar në emër të kryefamiljarit pa saktësuar të qartë bashkëpronarët, fenomeni merr përmasa ende më kritike. E njëjta gjë edhe në rastet e legalizimeve ku megjithëse kërkohet certifikata familjare, kjo e fundit praktikisht neglizhohet.

dhuna fizike mbi gruan në familje është e pamundur të luftohet me efikasitet në një kohë kur e drejta zakonore shqiptare mbi pronën, deformon të drejtën moderne, duke e kthyer gruan në një skllave në mungesë të mjeteve jetike për të qenë minimalisht e lirë.

Para se ta mbrojë nga dhuna, shoqëria

shqiptare duhet t'i japë gruas të drejtën për të qenë e lirë.

Vrasje apo vetëvrasje?!... Qëllimi dhe përfundimi?

Vetëvrasja shkatërron edhe mendimin se jeta ofron zgjidhje alternative të vazhdueshme dhe brendia morale e problemit nuk është kaq e zorshme sa duket... Familja shqiptare është nën peshën e krimit midis vetes, por edhe ndaj vetes, vetëvrasjet, dhuna seksuale është përhapur brenda gjinisë, pa folur për atëvrasës e mëmëvrasës të panumërt, që tmerrojnë ditaditës njerëzimin.

Nëse është e vërtetë që ndër shqiptarët, vetëvrasjet, incesti dhe krimi vrastar brenda gjakut është aq i përhapur sa njoftohet e komentohet rregullisht në shtyp, atëherë dikush duhet të kujtohet më së fundi të pyesë: këto krime me të cilat e ka ndarë veten njerëzimi qysh prej kohërave biblike, prej mbarimit të matriarkatit, prej krijimit të tabusë universale të përjashtimit të fëlligësisë në gjak, prej daljes së botës prej kompleksit të Edipit dhe shpëtimit të njeriut nga fataliteti i marrëdhënies brenda familjes, prej konsakrimit dhe shenjtërimit të familjes monogame, me kaq përhapje sa kanë, a nuk janë shenjë e një zgjimi barbar çmendurak, shenjë e një lajthitjeje të përgjithshme, që duhej të kish tronditur gjithë bashkësinë?!

Të gjitha këto raste “vrasje” apo “vetëvrasje”, Viktimat ikin duke lënë pas dyshimet e një bote dhe dilemat për një të ardhme më të mirë, familjet shkatërrohen por zgjidhjet nuk mësohen asnjëherë që ky fenomen të mos dendësohet siç ka ndodhur së fundmi.



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Fundi i vitit 2010 ishte viti i publikimit të një fenomeni i cili tronditi opinionin botëror, me përmasat dhe impaktit që pati. Një faqe interneti, në serverat e së cilës ndodheshin disa qindra-mijëra faqe me informacion të klasifikuar, u publikua në shtypin e lirë. Shkelja e këtyre parimeve bazë bëri të mundur që një analist ushtarak që shërbente në mision në Irak të publikonte në “Wikileaks” materiale të klasifikuara të cilat vunë në rrezik operacionet luftarake, reputacionin e ndërhyrjes dhe jetën e pjesëmarrësve. Publikimi i dokumenteve sekrete dhe konfidenciale nga “Wikileaks”, prej të cilave disa mijëra përfshijnë dhe Aleancën Atlantike, është i paligjshëm, i papërgjegjshëm dhe i rrezikshëm, “Wikileaks” publikoi, në muajin korrik të vitit 2010, dhjetëra-mijëra dokumente rreth operacioneve të drejtuara nga NATO në Afganistan. Shtetet e Bashkuara deklaruan se do të ndjekin ligjërisht çdo person përgjegjës për nxjerrjen e këtyre të dhënave, të publikuara në faqen “Wikileaks”. Mesazhet e para sekrete nga më tepër se 250,000 të tilla që ambasadat amerikane i dërgonin Uashingtonit u botuan në disa gazeta.

Me këtë fenomen të mundshëm, tashmë përballat çdo vend i NATO-s përfshirë Shqipërinë, pasi, aksesit i njëjtë i të gjithë pjesëtarëve të aleancës në informacionin e rezervuar bën të mundur edhe fenomenin “Wikileaks” nga përdoruesit shqiptarë të rrjeteve të klasifikuara të NATO-s. Ndërgjegjësimi, përzgjedhja, kontrolli i pastërtisë së figurës së këtyre përdoruesve është imediat edhe për FARSH-në në përgjithësi, por edhe të strukturave të inteligjencës ushtarakë në veçanti. Një zgjedhje jo e mirë e personelit, një verifikim sipërfaqësor i tij, një analist i gabuar i shërbimit inteligjent ushtarak shkaktoi një dëm, i cili llogaritet të jetë shumë më i madh se sa duket. “Leasons learned” është gjithçka që mund të behet për të rikuperuar dëmin dhe për të mos u përsëritur, përfshi këtu edhe vendin tonë.

“Kabllot” sekrete të diplomacisë amerikane, të publikuara nga “Wikileaks”, kanë hedhur pak dritë edhe në përgatitjet për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. “Kabllot” e lëshuara shfaqin përpjekjet për përgatitjen e shpalljes së njëanshme të pavarësisë, dhe më pas lobimin tek shtetet për ta njohur atë, shkruajnë mediat serbe, duke iu referuar dokumenteve të lëshuara nga “Wikileaks”. Amerikanët në veçanti ishin të shqetësuar se Rusia mund të vente veto ndaj tyre në OKB, ndërsa pati edhe ide që t’i ofrohej Marrëveshja e Stabilizim Asociimit Serbisë me BE-në.

Deri në fund të vitit 2006, siç tregojnë kabllot e lëshuara, SHBA-të menduan t’i ndihmojnë forcat demokratike në Serbi në zgjedhjet e caktuara për janarin e vitit të ardhshëm, dhe vendosën të ndalojnë së lobuari, dhe i ofruan Serbisë anëtarësim në programin e NATO-s, “Partneriteti për Paqe”. Ndërkohë, francezët kërkuar nga gjermanët që ta përkrahin MSA-në pa insistuar në bashkëpunimin e plotë të Serbisë me Tribunalin e Hagës. I gjithë ky material u gjet në “kabllot” që dokumentojnë bisedat në mes të Sekretarit Amerikan të Shtetit, Daniel Fried, dhe këshilltarit diplomatik të presidentit francez, Zhak Shirak. Sa i përket OKB-së, ata qysh në mesin e vitit 2007 e konsideronin çështjen e Kosovës të mbyllur. Kjo u zbulua në një dokument që në detaje jepte një bisedë mes Nënsekretarit Amerikan për Çështje Politike, Uilliam Bërns, dhe presidentin georgjian, Mikheil Saakashvili.

Departamenti (sipas kablllogamit) i kërkon Ambasadës së Tiranës të protestojë tek zyrtarët në mënyrë urgjente, duke i kërkuar fuqimisht qeverisë shqiptare që të refuzojë propozimet e qeverisë iraniane për të nënshkruar marrëveshjen e tregtisë së lirë dhe shkëmbimit kulturor sipas marrëveshjes me Iranin dhe vendosjen e një qendre ajrore iraniane në Shqipëri. Në vjeshtën e 2011 “Wikileaks” publikon edhe disa kablllograme të tjera të lidhura me Shqipërinë të cilët patën një impakt si në publik ashtu edhe në klasën politike. A është gjithmonë e dobishme gjithë kjo transparencë? Çfarë u fitua dhe çfarë u humb në këtë fushatë?

Unë gjykoj se u fitua më shumë se çfarë u dëmtua. Në një tjetër perspektivë analizohet “Wikileaks” nga Inteligenca lidhur me përdoruesit e informacionit sekret shtetëror nga kundërshtarët. Në këtë pikëpamje përdorimi dhe njohja e paautorizuar me informacion të klasifikuar të një vendi, është spiunazh. Drejtori i CIA-s, Mike Pompeo e quajti “Wikileaks”-in gjatë një fjale të tij në kongresin amerikan në prill 2016 “një shërbim inteligjence armiqësor, shpesh këta përgatiten nga aktorët shtetërorë si Rusia, siç ishte edhe fushata zgjedhore në SHBA. “Wikileaks” publikoi “e-mail”-et demokrate gjatë fushatës presidenciale të vitit 2016, për të kthyer fushatën kundër kandidatëve demokrate Hillary Clinton dhe në favor të republikanit Donald Trump që rezultoi fitues.

Themeluesi i “Wikileaks”, Julian Assange deklaroi se

WIKILEAKS, dilemma midis transparencës dhe sigurisë



publikimi i “e-mail”-eve demokrate nuk kishte si qëllim të ndikojë te zgjedhjet. Por çfarë qëllimi kishin lind pyetja? Kur qartësisht sulmohej njëri kandidat dhe mbrohej apo akoma më shumë mbështetej kandidati rival? Në mars 2016, “Wikileaks” publikoi dokumentet që kanë aparataturat e përgjimit të Agjencisë Qendrore të Inteligjencës, CIA, si dhe i kërkoj djalit të kandidatit Trump bashkëpunimin e tij në publikimin e dokumenteve, “Wikileaks” gjithashtu i sugjeroi Trump Junior, nëse Donald Trump fitonte, miratimin e pozicionit të Julian Assange si ambasador i Australisë në BE.

Djali i presidentit Donald Trump ka shkëmbyer mesazhe private me “Wikileaks” gjatë fushatës zgjedhore, ku Trump fitoi. Shkëmbimi i mesazheve ndodhi në të njëjtën kohë kur sulmohet websajti me e-mailat keqbërëse ndaj kandidatëve demokratë Hillary Clinton. Donald Trump Jr. i lajmëroi këshilltarët e lartë, duke përfshirë edhe kunatin e tij, Jared Kushner. Gjatë shkëmbimit të mesazheve, “Wikileaks” i kërkon Trump Juniorit për të publikuar e-mailat e hakeruara të Clinton dhe sugjeroi që Presidenti Trump të mos i pranonte rezultatet e zgjedhjeve, nëse ai nuk fiton. Mesazhet u publikuan për herë të parë nga faqja “Atlantic” dhe më vonë u postuan nga vetë djali i Trumpit në Twitter. Ai gjithashtu është akuzuar se është parë të takohet me një avokate ruse në Trump Tower, dhe se kishte dokumente shantazhuese rreth kandidatës demokrate Hillary Clinton. Shtëpia e Bardhë ka urdhëruar agjencitë e zbulimit për të kryer një inspektim të plotë të sulmeve kibernetike gjatë periudhave të fushatës elektorale, përfshirë vjedhjen e e-mail-eve që tronditën. CIA beson se Rusia ndërhyri për të ndihmuar fitoren e zotit Trump, përmes e-mail-ve të dorëzuara “Wikileaks”, me qëllimin krijimin e përshtypjes se kjo është liria e shtypit e pandikuar. CIA lobi në Shtëpinë e Bardhë për të ripërcaktuar “Wikileaks” dhe një

numër gazetarësh të profilit të lartë, përfshin Glenn Greenwald dhe Laura Poitras si “ndërmjetësit e informacionit”. A është “Wikileaks” një media gazetareske? A janë vërtet Laura Poitras dhe Glenn Greenwald gazetarë. Glenn Greenwald dhe Laura Poitras, të cilët publikuan historinë e Snowden dhe u takuan me të në Hong Kong, ishin në qytetin e Nju Jorkut për të marrë çmimin prestigjioz “George Polk”. Greenwald, më parë një redaktor i “The Guardian” dhe tani një partner në sipërmarrjen e ardhshme mediatike “First Look”, dhe “Poitras”, një skenarist dokumentarësh, do të ndajnë çmimin e gazetarisë me Ewen MacAskill të “The Guardian” dhe Barton Gellman të “Washington Post”, raporton “Huffington Post”. Më 22 maj 2023, “Meta” u gjobit me 1.3 miliardë dollarë dhe urdhëroi të ndalojë dërgimin e të dhënave evropiane të përdoruesve në SHBA. Pas Julian Asage edhe Edward Snowden është personazhi i cili nën flamurin e lirisë së medias dhe me qëllim denoncimin e shkeljeve të lirisë themelore të njeriut, është hedhur në prehrin (mbrojtësit të demokracisë) Putinit. Edward Joseph Snowden lindur më 1983, në Karolinën e Veriut, ishte, kontraktues i inteligjencës amerikane në vitin 2013, kur deklaroi ekzistencën e programeve sekrete të mbledhjes së informacionit nga (NSA). Ai e la shkollën e mesme dhe studioi me ndërprerje midis 1999 dhe 2005 në një kolegji komunitar; ai përfundoi një GED, por nuk mori një diplomë kolegji. Ai u regjistrua në rezervën e ushtrisë si kandidat i forcave speciale në maj 2004, por u lirua katër muaj më vonë. Në vitin 2005 ai punoi si roje sigurie në Qendrën për Studim të Avancuar të Gjuhës, një strukturë kërkimore e Universitetit të Maryland-it e lidhur me NSA. Pavarësisht mungesës relative të arsimit dhe trajnimit formal, Snowden tregoi aftësi me kompjuter dhe ai u punësua

nga Agjencia Qendrore e Inteligjencës në vitin 2006. Atij iu dha një leje sekrete dhe në vitin 2007 u dërgua në Gjenevë, ku punoi si ekspert teknik sigurie në mbulesë diplomatike. Snowden u largua nga CIA për NSA në vitin 2009, ku punoi si kontraktor privat për kompanitë “Dell” dhe “Booz Allen Hamilton”. Gjatë kësaj kohe, ai filloi të mbledhë informacione për një sërë aktivitete të NSA-së, më së shumti, programet e mbikëqyrjes sekrete që ai besonte se ishin tepër të gjera në përmasa dhe shtrirje.

Në maj 2013, Snowden kërkoj leje mjekësore dhe fluturoi për në Hong Kong, ku kreu një seri intervistash me gazetarët e gazetës “The Guardian”. Ndër sekretet e NSA-së të zbuluara nga Snowden ishte një urdhër gjykatë që detyroi kompaninë e telekomunikacionit “Verizon” të dorëzonte të dhënat “meta” (të tilla si numrat e telefonave dhe kohëzgjatja e thirrjeve) për miliona abonentë të saj. Më 9 qershor 2013, pasi tregimet e tij u botuan fillimisht në “The Guardian” dhe “The Washington Post” pa zbuluar identitetin e burimit të tyre, Snowden deklaroi se nuk ndjente nevojë të fshihej, sepse nuk kishte bërë asgjë të keqe.


Në një intervistë të mëvonshme me “South China Morning Post”, ai pretendoi se NSA kishte hakuar kompjuterët kinezë që nga viti 2009 dhe se ai kishte punuar me “Booz Allen Hamilton” shprehimisht për të marrë informacione rreth aktiviteteve sekrete të NSA-së. SHBA e akuzoi Snowden për spiunazh më 14 qershor dhe zyrtarët e Departamentit të Drejtësisë, përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm Eric Holder, filluan negociatat me autoritetet në Hong Kong në një përpjekje për të nisur procedurat e ekstradimit. Qeveria e Hong Kongut refuzoi të vepronte dhe Snowden, me ndihmën e organizatës mediatike “Wikileaks”, fluturoi për në Moskë, ku vendndodhja e tij e saktë u bë burim spekulimesh intensive. Presidenti rus. Vladimir Putin konfirmoi se Snowden, të cilit i ishte hequr pasaporta nga SHBA-të, mbeti brenda kufijve të zonës transitore ndërkombëtare të aeroportit Sheremetyevo të Moskës. Putin deklaroi me vendosmëri se Rusia nuk do të merrte pjesë në ekstradimin e tij në Shtetet e Bashkuara dhe Snowden aplikoi për azil në rreth 20 vende, përfshirë Rusinë.

Pasi kaloi më shumë se një muaj në zonën e tranzitit të Sheremetyevo, Snowden-it iu dha statusi i përkohshëm i refugjati nga Rusia dhe ai u largua nga aeroporti në shoqërinë e një punonjësi të “Wikileaks”.

Në prill 2014, “The Guardian US” dhe “The Washington Post” u nderuan me Çmimin “Pulitzer” për shërbimin publik për rolin e tyre në raportimin mbi rrjedhjet e NSA. Në gusht të vitit 2014, me skadimin e dhënies së azilit të përkohshëm të Snowden-it, qeveria ruse

i dha atij një leje qëndrimi trevjeçare, u zgjat në vitin 2017 dhe Snowden-it iu dha leja e qëndrimit të përhershëm në vitin 2020. Në shtator 2022, presidenti rus. Vladimir Putin i dha Snowden-it shtetësinë ruse. Pse e dekoron Putin një amerikan të NSA-së? Çfarë e shtyn dhe çfarë fuqie ka një përfaqësues i “Wikileaks”, të marrë Snowden dhe ta transferojë në Rusi? Sepse ai po e bën botën më transparente. Absolutisht vetëm për spiunazh dhe në favor të Rusisë. Rasti i fundit është raportuar më 14 prill 2023, kur gardisti Jack Teixeira, 21 vjeç arrestohet pasi akuzohet për vjedhjen dhe publikimin e dokumenteve të Pentagonit. Ushtri amerikan punonte si specialist i IT për inteligjencën në Gardën Kombëtare Ajrore të Masaçusetes. Parimi bazë në punën me informacion është klasifikuar “sekret shtetëror” është përzgjedhja e personelit, i cili do të ketë akses në këtë informacion dhe respektimi i parimit “need to know” (nevojë për të ditur). Kjo është shkelja më e rëndë e këtij parimi dhe tradhtia më e rëndë ndaj sekreteve shtetërore në SHBA prej 10 viteve të fundit. Përmbytja e tyre, nëse është e vërtetë, në disa raste, mund të sjellë dëme të prekshme dhe rrezikojnë jetë njerëzish. Por veç kësaj, ka edhe gjëra me shumë interes që ndoshta do të donim t’i analizonim pak më thellë. Më shumë se 500 dokumente nga shërbimet sekrete amerikane qarkulluan në forumet e internetit. Gjithçka, që nga pozicionet e mbrojtjes kundërajrore në Ukrainë, analizat për dobësinë e forcave të armatosura ruse dhe ukrainase, supozimet për një sëmundje të mundshme të Vladimir Putin etj.; ishin në platformat digjitale. Më 21 dhjetor 2018, “Wikileaks” publikon një bazë të dhënash të kërkueshme me më shumë se 16,000 kërkesa prokurimi të postuara nga ambasadat e Shteteve të Bashkuara rreth botës. Cili ishte ky fenomen i ri që po ndodhte? Kush janë përfituesit dhe humbësit nga kjo formë e re e operacioneve me informacionin?





Stema heraldike e familjes Muzaka

Dinastia Muzakaj

Fitoret e Andrea II Muzakës kundër bullgarëve dhe dyndjeve serbe, e entuziazmuan Perandorin e Bizantit, i cili, krahas titullit sevastokrator, i njohu të drejtën të përdorë në stemën e Muzakajve, stemën perandorake me shqiponjën dykrenore me krahët e hapura, me kurorat mbi kokat dhe yllin gjashtë cepa, në sfond blu mbi kokat e shqiponjës. Për këto merita dhe forcimin e pozicionit politik dhe ushtarak të Andrea Muzaka II, perandori i dha titullin Dhespot i Epirit dhe i njohu privilegjin të përdorë vulën e artë me stemë perandorake, si dhe i dhuroi një fron dhespotal, që kishte në pjesën e sipërme të shpinore shqiponjën dykrenore të qëndisur me perla. Në një nga statuetat e Muzakajve, në gjoksin e shqiponjës janë tre gjethe dushku, simbol hyjnor i lidhur me tempullin e Dodonës. Gjon Muzaka në kujtimet e tij, tregon se krahas shqiponjës dykrenore, Perandori i Bizantit iu kishte dhënë të drejtën të vendosnin në stemën e tyre “Burimin e jetës”. Sipas Rosario Jurlario, kjo e drejtë lidhet me raportet e bashkëpunimit të Muzakajve me familjet perandorake. Për Muzakajt është karakteristike ruajtja e stemës heraldike me shqiponjën dykrenore, në ndryshim nga Kastriotët, Granai, Bua etj., të cilët e ndryshuan stemën në vartësi të meritave dhe të titujve që iu njohën nga Venediku, nga Aragonezët dhe nga Anzhuinët.

Stema heraldike e Muzakajve ruhet ende në fasadat e disa pallateve dhe të disa kishave të komunës Mesagne, ku u vendos fillimisht Gjon Muzaka me familjen e tij. Në pjesën e mbetur nga kisha Shën Maria Mëshirëmadhe, në paretin anësor janë katër basorelieve, njëri prej tyre prezanton një kombinim të stemës të Muzakajve me shqiponjën dykrenore me kurorat dhe me yllin gjashtë cepash, me gjysmën e djathtë me luanin në këmbë, me shpatë drejtuar zambakut, që ishte pjesë e stemës të familjes të Gjon Granai Kastriotit. ky basorelieve është element i varrit të Gjon Granai Kastriotit (nipi i Vrana Kontit), i cili vdiq në Mesagne, më 2 gusht 1514, dhe e varrosën në kishën Shën Maria Mëshirëmadhe, kishë e ndërtuar në shekullin XVI me kontributet bujare të familjeve Granai dhe Muzaka. Për meritat ushtarake dhe forcimin e pozicionit politik të princit të Muzakisë, sevastokratorit Andrea II Muzaka, Perandori i Bizantit Androniku Paleologu II e emëroi Dhespot i Epirit. Emërimi dhespot i fisnikëve në Perandorinë Bizantine, bëhej me ceremoni, gjatë emërimit të Karlit dhespot nga Michele Paleologu VIII (1223-1282). Ceremonia zhvillohej në oborrin perandorak, ku mblidheshin komandantët e ushtrisë dhe njëri nga dinjitarët lexonte vendimin, që theksonte meritat dhe sukseset në detyrat e ngarkuara nga Perandori, ndërsa kryekomandanti i ushtrisë shpallte emërimin Dhespot personin direkt, ose ambasadorin e dërguar prej tij. Në shekullin XIII – XIV, prijësit e Muzakisë kishin titujt sebastonkreator dhe protosebast, ndërsa Andrea Muzakën II e emëruan Dhespot i Epirit dhe i Muzakisë, madje ishte i katërti në radhë ndër dhespotët e emëruar nga Perandori i Bizantit. Nga martesat e Andrea Muzaka II me Eftiminë lindën pesë fëmijë, tre djem: Gjini II, Teodori, Stoja dhe dy vajza Komita e Kirana.

Andrea II Muzaka vdiq në vitin 1372, dhe e varrosën në Kishën e Shën Antonio në Durrës. Në gjysmën e dytë të shekullit XIV, nga konflikti i Paleologut me Kantakuzenin, Perandoria Bizantine rrezikohet të shpërbëhej. Paleologu për të thyer Kanatakuzenin kërkoi ndihmën e Sullta Muratit I, i cili duke filluar nga viti 1363 sulmoi shtetet Ballkanike. Ushtria turke pasi pushtoi Despotatet e Artës dhe të Janinës, sulmoi trojet e Muzakajve. Princat arbëror me në krye Balshën II, me Muzakajt, Gropajt, Topiajt etj., më 18 shtator 1385, e pritën ushtrinë turke në Savër të Myzeqesë dhe pas një beteje të ashpër, forcat e koalicionit arbëror u thyen dhe princat arbëror u detyruan të bëhen vasalet të Perandorisë Osmane. Sukseset e ushtrisë Osmane, e shtuan urreksin e Sulltan Muratit I, i cili avancoi

në veri. Dhespoti i Serbisë Lazari, mbreti i Bullgarisë Marko dhe Dhespoti i Epirit Teodori I Muzaka, së bashku me prijësit e tjerë arbëror Gjergji II Balsha, Pal Kastrioti, Dhimitër Joanima, Andrea Gropa etj., i bashkuan ushtritë kundër ushtrisë turke të Muratit I. Më 28 qershor 1389, në Fushë Kosovë u zhvillua një betejë e ashpër, ku mbeti i vrarë prijësi Teodori I Muzaka (djali i Gjinit II Muzaka) dhe dhespoti i Serbisë Lazari.

Nga viti 1394 e në vazhdim, shteti i Muzakajve u sulmua nga ushtria dhe nga flota turke. Fillimisht, Muzakajt i rezistuan dhe i zmbarsën sulmet turke, por më pas, në sajë të superioritetit numerik dhe armatimeve të ushtrisë turke, u detyruan të tërhiqen e të njohin sovranitetin e sulltanit, por ruajtën një pozicion diplomatik, si ndërmjetës mes Perandorisë Osmane, me republikat e Venecias dhe të Raguzës. Athanas Gegaj shkruan: “Prijësi i Muzakajve, në vitet e para të shekullit XV, priti ambasadorin e Republikës së Raguzës Mikele de Resti, të cilit i kërkoi të ndërmjetësonte te turqit, që të lironin princin Nikita Topia të Krujës, që e kishin arrestuar dhe burgosur. Pas vdekjes më 1389 të Gjinit II dhe Teodorit I, në krye të zotërimeve të Muzakëve ishte Andrea Muzaka III, i ati i Gjini Muzakës III dhe gjyshi i Gjon Muzakës, autori i kujtimeve të familjes Muzaka. Gjini III u martua me Kirana, mbesa e sevastokratorit Pal Matranga i Gorës dhe kishin tetë fëmijë, dy djem e gjashtë vajza. Gjini Muzaka III, ishte prijësi i fundit që ruajti sovranitetin e shtetit të Muzakisë. Gjini III Muzaka vdiq në Sereizabunga në verën e vitit 1417, para se Berati të pushtohej nga Turqit. Gjini III e varrosën në kishën e Shën Maria në Bunga, madje në këtë kishë varrosën dhe Kiranën gruan e tij (nëna e Gjon Muzakës) Në verën e vitit 1417, hordhitë osmane pushtuan Beratin, me trevat dhe fshatrat në vartësi të Muzakajve dhe ngritën administratën turke në Berat dhe në të gjitha trevat që ishin në zotërim të Muzakajve. Në vitet 1432 dhe 1436, prijësi i muzakajve, Teodori Muzaka III, u bashkua me Gjergj Arianitin, kunatin e tij në kryengritjen kundër pushtuesve turq dhe i thyen hordhitë turke. Të drejtat që fituan Muzakajt, e preokupuan sulltanin, i cili dërgoi ushtrinë e komanduar nga Turhan Pasha, që e rrethoi Beratin. Arbërorët rezistuan gjatë sulmeve turke. Në vitin 1443, të mbështetur dhe nga forcat e Gjergj Arianitit, ushtria turke u detyrua të tërhiqet dhe Muzakajt rimorën Beratin dhe trojet e tyre. Me kthimin e Gjergj Kastriotit në Arbëri, filloi periudha e re historike, rezistenca heroike kundër sulmeve të vazhdueshme të ushtrisë turke. Më 2 mars 1444, në Lezhë, që ishte në zotërim të Venedikut, Gjergj Kastrioti mblodhi në kuvend princat arbërorë: Arianiti, Teodori Muzaka III, Dukagjini, Topia, Zakaria, Spani, Balsha, Dushmani, Cernoviçi i Malit të Zi etj., ku krijuan Besëlidhjen e Lezhës, aleanca e princave për mbrojtjen e trojeve arbërore nga sulmet e ushtrisë të Perandorisë Osmane. Gjergj Kastrioti, u zgjodh kryekomandanti i ushtrisë arbërore. Muzakajt ishin aleatët besnikë të Kastriotit, madje Gjergj Kastrioti dërgoi Gjini Muzakën III, t'i kërkonte Gjergj Arianitit fejesën me Andronikën. Në kujtimet e tij Gjon Muzaka shkruan: “Scanderbegho... lo mandò a consultare con lo signor Ginno mio padre, che il detto signor Aryaniti era cognato a mio padre, perchè ebbe per moglie la Signora Maria Musachi, sorella del mio padre... Signor Scanderbego Castriota fu Signor de Dibra, de Mati e de Croya insino alla marina, e Deberina, cioè Randesio, e la paese de Guonimi”, - Kastrioti ishte zot i Dibrës, i Matit i Krujës deri në det, ku përfshihej Kepi i Rodonit dhe në veri

trojet e Jonimëve.

Muzakajt e mbështetën Gjergj Kastriotin në të gjitha betejat kundër ekspeditave të vazhdueshme të ushtrisë osmane. Në luftimet kundër turqve mbeti i vrarë Teodor Muzaka III, i cili nuk ka lënë trashëgimtarë. Bazuar në gatishmërinë dhe besnikërinë e Muzakajve, Gjergj Kastrioti iu besoi misionet të rëndësishme diplomatike, si rasti i Martin Muzakës, të cilin në qershor 1460, e dërgoi në Vatikan, t'i dorëzonte një letër konfidenciale Papës Piu II dhe mbretit Ferrante Anzhuin II.

Në betejën e Vajkalit në Bulqizë, në vitin 1465, kapedanët Moisi Golemi, Gjini Muzaka (i biri i Matrenga Muzakës), Vladan Gjura, Muzaka i Angjelinës, Gjini Manësi, Gjon Perlati, Nikolla Erizi, Gjergj Kuka, u kapën rob nga turqit e Ballaban Pashës, pasi u tradhtuan nga çermentikasit Gjoni dhe Isufi, të cilët Sulltani i shpërbleu duke iu dhënë timaret e fshatrave Gradec, Lunik, Neshta e Kostenja, troje që ishin në pronësi të Muzakës të Angjelinës.

Gjon Muzaka dhe prijësit e tjerë arbëror Arianiti, Dukagjini, Spani, Balsha vazhduan t'i rezistojnë sulmeve të ushtrisë turke, deri në rënien e Shkodrës dhe me aktin e pushtimit të trojeve arbërore nga Perandoria Osmane, të firmosur në Stamboll nga ambasadori i Venedikut dhe Sulltan Mehmeti II – Fatihu. Në kujtimet e tij, Gjon Muzaka tregon se gjatë viteve që ndodhej në Arbëri, i ruajti lidhjet dhe e mbështeti proveditorin e Venedikut në Durrës, madje kur Frederiku Aragon, shkoi me ushtrinë e të atit Ferrante II për të marrë Durrësin, Gjon Muzaka në krye të reparteve të kalorësisë dhe të këmbësorëve, shkoi në ndihmë të Venedikut për të mbrojtur Durrësin nga princi Federik. Por ky kontribut nuk u shpërblje nga Venediku, sepse kur firmosi aktin e paqes me mbretërinë e Napolit, jo vetëm nuk e ftoi Gjon Muzakën, por dhe e braktisën. Këto qëndrime pabesie të Venedikut e kishin provuar dhe princa të tjerë arbëror. Pas vdekjes të Gjergj Kastriotit, Sulltan Mehmeti II i propozoi Gjon Muzakës, nëse do të bashkohej me turqit dhe të konvertohej në fenë islame, do t'i njëhte të drejtat e pronësisë të trojeve të Muzakisë. Rreth këtij propozimi të Sulltanit, Gjon Muzaka në kujtimet e tij shkruan: “Mehmeti disa herë më dërgoi letra, duke me shkruar se nëse do të dëshiroja të shkoja te Ai së bashku me ju bijt e mi dhe të ndërroja fenë, më betohej se do të më lejonte të qeverisja të gjitha trojet tona, por unë nuk pranova të braktis fenë time të shenjtë pra e ruajta nderin e shtëpisë tonë. Në këtë kohë disa miq të mirë nga Durrësi, më informuan se duhej të largohesha, pasi më rrezikohet jeta. Kështu u detyrova të ndryshoj veshjen dhe një natë të vitit 1476 hipa në një varkë, bashkë me të tjerë, të cilët nuk dinin cili isha dhe kështu i shpëtova turqve. Pas këtij viti gjithçka shkoi së prapthi në trojet tona atë kohë, bashkëshortja ime, nëna e juaj Maria Dukagjini, që ishte shtatzënë me Andrianon, shkoi në Durrës dhe u strehua në shtëpinë e miqve tanë fisnikë, ku dhe e lindi Andrianon, të cilin e çuan në kishë dhe e pagëzuan pa e ditur i biri i kujt ishte. Ndërkohë, Teodori dhe Helena ishin strehuar në shtëpitë e fisnikëve të tjerë durrsakë. Një ditë kur turqit u vunë në kërkim të nënës tuaj dhe të ju fëmijëve tanë, Maria u fsheh brenda një dysheku me pupla, kështu me ndihmën e zotit mëshirëmadh nuk e zbuluan, miqtë tanë i mbrojtën nënën tuaj edhe ju, kështu shpëtuan i mizorisë së turqve. Një ditë, miqtë tanë fisnikë, e ndihmuan nënën tuaj, së bashku me ju të tre fëmijët tanë dhe iu hipën në një anije, që iu zbriti në brigjet e Puglias”.

Kujtime dhe mall për shkollën “Skënderbej”

Vasil Peçi, futbollisti i njohur i “Partizanit”, shkëlqeu në këtë sport veçanërisht kur erdhi për studime në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Ai lindi më 27 korrik 1958, në Çarshovë të Përmetit dhe shkëlqeu si pjesëmarrës në ekipin përfaqësues të shkollë, në ekipin e të rinjve të “Partizanit” dhe veçanërisht në ekipin e parë “Dinamo”, ku ka luajtur me disa nga ikonat e futbollit shqiptar të atyre viteve.

Në kujtimet e tij, Peçi do shkruante me mall dhe dashuri për vitet skënderbegase: “Vitet e fëmijërisë, shënojnë fillimin e ëndrrave për të ardhmen, të cilat ndërthureshin jo vetëm me profesionin, ku më shumë më pëlqente profesioni i oficerit, por edhe me pasionin e madh për futbollin, të cilin kisha filluar ta ushtroja që në shkollën fillore. Pra isha vënë përballë ëndrrës për t’u bërë oficer dhe pasionit e dëshirës për të vazhduar futbollin, të cilat mund të mishëroheshin, vetëm nëse do të ndiqja Shkollën Ushtarake “Skënderbej”. Dhe kështu vendosa. Në gusht 1973, marr emrin “Skënderbegas”, duke realizuar kështu ëndrrën e fëmijërisë. Dhe gushti i atij viti, shënoi fillimin e një jete krejt të ndryshme, krahasuar me vitet e fëmijërisë. Vinim në një mjedis tërësisht të panjohur, shumë të vështirë për moshën që kishim, me kërkesa shumë të larta dhe me angazhim të madh e të vazhdueshëm gjatë gjithë ditës, të cilat të përziera me kujtimet e bukura të jetës së fëmijërisë dhe mallin për familjen, përbënin një sfidë të vërtetë, në radhë të parë të qëndrueshmërisë së karakterit tonë.

Por me kalimin e ditëve të para, dalëngadalë fillon ambientimi me jetën ushtarake, si dhe njohja dhe krijimi i shoqërive të para, të cilat do të konsolidoheshin më tej në vitet dhe dekadat e ardhshme. Fillimi i procesit mësimor na mundësoi njohjen me shokët e rinj të klasës që vinin nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, të cilët i kujtoj me radhë, duke filluar me Robert Mulellari dhe Shkëlqim Mullaj, të cilët i kisha edhe shokë të ekipit të futbollit. Në vazhdim, dua të kujtoj me shumë mall shokët e tjerë të klasës si Dëshmorin e Atdheut Albert Lelaj dhe më tej, Bardhyl Hoxha, Fuat Spahiu, Shërbet Zguro, Artan Babi, Maksim Malaj, Agim Hysi, Robert Dervishi, Bashkim Abazi, Dhori Spirollari, Vladimir Qirjazi, Rahman Lupi, Hasan Ahmetaj, Petrit Koka, Kolë Gjoka, Tonin Qitaj, Dashamir Shehi, Nikollaq Pano, Vasil Karoli, Ferit Olldash, Durim Beqiri, Koço Kita, Preng Lala, Fatos Zeneli, Luan Alia, Llazar Zguro, Pali Sota, Vasil Peçi, Sinan Rrodhaj, Shkëlqim Mullaj, Kastriot Shurdhi, Kastriot Manaj, Emiliano Koxhioni, Sali Kasa, Dhiogjen Thanasi, Perlat Skëndo dhe Preng Lala. Me respekt te veçantë kujtoj mësuesin tonë kujdestar Mato Idrizi, një ndër zbuluesit më të mirë të kohës, i cili kishte bërë përzgjedhjen e klasës tonë, duke krijuar për herë të parë klasën e Radio-Zbulimit në shkollën “Skënderbej”, ku si veçori nga klasat e tjera kishte edhe mësimin e gjashtë gjuhëve të huaja, përkatësisht nga 6 grupet respektive. Krenaria e të qenit në këtë klasë, si dhe motivimi dhe mbështetja që na ka dhënë mësuesit Mato Idrizi, Besnik Karafilin, Gjeraqina Spahiu, Ana Prifti, Fiqiri Shtëpani, Inxhinier Shaban Bardhoshi, Drita Karoli, Vasilika Vasi, Skënder Shkupi, Sanie Tabaku, Inxhinier Jorgji Kona, Astrit Greva etj., krijuan një mjedis shumë të ngrohtë, çka ndikoi shumë pozitivisht në jetën tonë të përditshme dhe në rezultatet e shkëlqyera të klasës, të cilat janë padyshim një rast i veçantë për të gjithë historinë e Shkollës “Skënderbej”. Një fakt tjetër që e bën klasën tonë është se nga gjiri i saj kanë dalë katër gjeneralë dhe konkretisht Bardhyl Hoxha, Maksim Malaj, Dhori Spirollari dhe Vladimir Qirjazi. Pas përfundimit të Shkollës Ushtarake “Skënderbej” me rezultate të shkëlqyera, nga viti 1978-1981 përfundova studimet në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Brendshme, Dega Kufi, dhe titullova oficer kufiri. Gjatë karrierës time, kam pasur nderin t’i shërbej vendit tim, për rreth 10 vjet, si oficer kufiri dhe konkretisht nga vitet 1981-1988 në Konispol dhe nga viti 1988-1991 në Çarshovë, ku për shkak të reformës kam dalë në rezervë.

Ndërsa jam krenar për vitet e qenies nën uniformë nga viti 1973 deri në vitin 1991, më poshtë dua të shpreh aktivitetin dhe emocionet, që lidhen me vazhdimin e pasionit tim për futbollin. Ishte viti 1973, i sapo ardhur në shkollën “Skënderbej”, ku në një veprimtari sportive, përfshirë edhe futbollin, profesori i paharruar Melsi Çobani, më përzgjedhi si një futbollist me të ardhme. Më tej, bëhem pjesë e ekipit të shkollës “Skënderbej”, me trajner të



“VITET E FËMIJËRISË, SHËNOJNË FILLIMIN E ËNDRRAVE PËR TË ARDHMEN, TË CILAT NDËRTHURESHIN JO VETËM ME PROFESIONIN, KU MË SHUMË MË PËLQENTE PROFESIONI I OFICERIT, POR EDHE ME PASIONIN E MADH PËR FUTBOLLIN, TË CILIN KISHA FILLUAR TA USHTROJA QË NË SHKOLLËN FILLORE. PRA ISHA VËNË PËRBALLË ËNDRRËS PËR T’U BËRË OFICER DHE PASIONIT E DËSHIRËS PËR TË VAZHDUAR FUTBOLLIN, TË CILAT MUND TË MISHËROHESHIN, VETËM NËSE DO TË NDIQJA SHKOLLËN USHTARAKE “SKËNDERBEJ”.

palodhurin dhe pasionantin e jashtëzakonshëm Sherif Çiçiku, ekip i cili përfaqësonte edhe para të rinjtë e “Partizanit”. Ndërsa në vitin 1974-1977, kam përjetuar emocione të veçanta kur u bëra pjesë ekipit të të rinjve të “Partizanit”, por gjithsesi, duke mbetur “besnik” i ekipit të shkollës, ku për 4 vjet e përfaqësova në të gjitha kampionatet dhe veprimtaritë në nivel shkollash të mesme në Tiranë, duke i fituar të gjitha kupat dhe duke bërë krenarë qindra skënderbegas, të cilët na ndiqnin kudo. Në këto ndeshje kam patur fatin të kem “kundërshtar” të pa harruarin Arben Minga dhe më tej, Agustin Kola, Halit Gega, Edmond Gëzdari, Skënder Hodja, Kiço Mile etj.

Po ashtu përfaqësim të shkëlqyer kemi bërë edhe në spartakiadat e ushtrisë. Mbresëlënëse kanë qenë edhe ndeshjet e zhvilluara në stadiumin kombëtar “Q. Stafa” dhe në stadiumet e fushat sportive në rrethe të ndryshme, duke promovuar ekipin e “begsave” në të gjithë Shqipërinë. Me këtë rast, kujtoj me shume dashuri shokët e ekipit të shkollës: Perlat Musta, Artur Lekbello, të paharruarin

Arjan Hametaj, Robert Mulellari, Shkëlqim Mullaj, Haziz Çeço, Bektash Duduni, Agron Hysi, Ismail Bajrami, Sokol Qehaja, Feta Guri, Agron Hoxha etj. Pas përfundimit të Shkollës “Skënderbej”, në vitet 1977-1980, kam përjetuar emocione të veçanta, kur u bëra pjesë ekipit të parë të “Dinamos”, duke pasur shokë ekipi mjaft futbollistë të spikatur të asaj kohe, ku veçoj Mujo Targaj, Halit Gega, Artur Çobani etj.

Meditimi rreth veprimtarisë time ushtarake dhe sportive, copëza të së cilës i përshkrova më lart, më kthejnë edhe një herë tek shoqëria ime e Shkollës “Skënderbej”, që daton në vitin 1973, të cilën e kujtoj në çdo kohë me mall dhe nostalgji, ku falë edhe angazhimit të disa shokëve si Robert Mulellari, Shkëlqim Mullaj, Vasil Karoli, Bardhyl Hoxha, Shërbet Zguro, Vladimir Qirjazi, Maksim Malaj, Rahman Lupi, Durim Beqiri, Koço Kita, Kolë Gjoka, Artan Babi, Tonin Qitaj etj., vazhdon të jetë e qëndrueshme.

NATO rrit forcën e inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit me aftësi shtesë

Pas vendimeve të marra në Samitin e Uashingtonit, drejtorët kombëtarë të armatimeve kanë rënë dakord për një strategji për të përmirësuar Forcën e Inteligjencës, Mbikëqyrjes dhe Zbulimit të NATO-s (NISRF) me aftësi shtesë. Marrëveshja e marrë më 9 korrik 2024 nga Konferenca e Drejtorëve të Armatimeve Kombëtare (CNAD) do të ofrojë më shumë aftësi Inteligjence, Mbikëqyrjeje dhe Zbulimi (ISR) për të mbështetur më mirë NISRF.

Nëpërmjet NISRF, aleatët bashkëpunojnë ngushtë për të mbledhur, analizuar dhe ndarë të dhënat e inteligjencës në të gjitha fushat, duke përfshirë hapësirën. Kjo ndihmon në përmirësimin e raportimit dhe mbështetjen e misioneve dhe operacioneve të NATO-s. NISRF është një pjesë e rëndësishme e rrjetit më të madh të inteligjencës së NATO-s në të gjithë Shtabin e NATO-s, Strukturën e Komandës së NATO-s, Strukturën e Forcave të NATO-s dhe rrjetet shumëkombëshe dhe kombëtare.

Rritja e aftësive të NISRF do të forcojë aftësitë e përgjithshme ISR të NATO-s dhe paralajmërimin dhe kontrollin e hershëm. Këto përpjekje përfshijnë programin e Aleancës për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Ardhshëm (AFSC), nismën e Oqeanit Dixhital, iniciativat shumëkombëshe për Sistemet e Avionëve të Pilotuar nga Distanca (RPAS) dhe Mbikëqyrjen e Përhershme të Aleancës nga Hapësira (APSS).

Inteligjencë, Vëzhgim dhe Zbulim i Përbashkët

Inteligjenca, Mbikëqyrja dhe Zbulimi i Përbashkët (JISR) është jetik për të gjitha operacionet ushtarake. Ai u siguron vendimmarrësve dhe ndërmarrësve të veprimeve një ndërgjegjësim më të mirë të situatës për kushtet në tokë, në ajër, në det, në hapësirë dhe në fushën kibernetike. Aleatët punojnë së bashku për të mbledhur, analizuar dhe ndarë informacionin me efekt maksimal. Kjo e bën Joint ISR një shembull unik të bashkëpunimit dhe ndarjes së barrës në të gjithë Aleancën.

NATO ka krijuar një sistem të përhershëm JISR që ofron informacion dhe inteligjencë për vendimmarrësit kryesorë, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të mirëinformuara, në kohë dhe të sakta. JISR është një element kyç i operacioneve dhe misioneve të NATO-s dhe një gur themeli i qëndrimit parandalues dhe mbrojtës të Aleancës.

JISR bashkon të dhënat dhe informacionin e mbledhur përmes projekteve të tilla si sistemi i mbikëqyrjes tokësore të Aleancës së NATO-s (AGS) ose avionët e mbikëqyrjes së Sistemit të Paralajmërimit dhe Kontrollit Ajror të NATO-s (AWACS), si dhe një shumëllojshmëri të gjerë të aseteve kombëtare JISR nga hapësira, ajri, toka dhe domenet detare.

Si mbikëqyrja ashtu edhe zbulimi përfshijnë vëzhgimin vizual (nga ushtarët në tokë) dhe vëzhgimin elektronik (për shembull nga satelitët, sistemet e avionëve pa pilot, sensorët tokësorë dhe anijet detare), të cilat më pas analizohen, duke e kthyer informacionin në inteligjencë. Në shkurt 2023, një grup aleatësh të NATO-s, së bashku me ish-të ftuarit Finlandën dhe Suedinë (tani vende anëtare të NATO-s), njoftuan planet për të nisur iniciativën e Aleancës për Mbikëqyrjen e Përhershme nga Hapësira (APSS), e cila do të transformojë mënyrën se si NATO mbledh dhe përdor të dhënat nga hapësirë, përmirësojnë ndjeshëm inteligjencën dhe mbikëqyrjen e NATO-s dhe ofrojnë mbështetje thelbësore për misionet dhe operacionet ushtarake të Aleancës.

Komponentët

Inteligjenca, Mbikëqyrja dhe Zbulimi (ISR) siguron themelin për të gjitha operacionet ushtarake dhe parimet e saj janë përdorur në luftë për shekuj. Elementet individuale të ISR janë:

Inteligjenca: produkti përfundimtar që rrjedh nga vëzhgimi dhe zbulimi, i shkrirë me informacione të tjera;

Mbikëqyrja: monitorimi i vazhdueshëm i një objekti; dhe

Zbulimi: mbledhja e informacionit e kryer për t'iu përgjigjur një pyetjeje specifike ushtarake.

Si vëzhgimi ashtu edhe zbulimi mund të përfshijnë vëzhgimin vizual (për shembull ushtarët në tokë që shikojnë fshehurazi një objekt, ose sistemet e avionëve pa pilot (UAS) me kamera), si dhe vëzhgimin elektronik.

Dallimi midis vëzhgimit dhe zbulimit ka të bëjë me kohën dhe specifikën; mbikëqyrja është një aktivitet më i zgjatur dhe i qëllimshëm, ndërsa misionet e zbulimit janë përgjithësisht të shpejta dhe të synuara për të tërhequr informacione specifike.

Pasi të jetë marrë informacioni i vëzhgimit dhe zbulimit, specialistët e inteligjencës mund ta analizojnë atë, t'i bashkojnë ato me informacione të tjera nga burime të tjera të dhënash dhe të prodhojnë inteligjencën, e cila më pas përdoret për të informuar vendimmarrësit ushtarakë dhe civilë, veçanërisht për planifikimin dhe kryerjen e operacioneve.

Ndërsa të gjitha vendet kanë burimet dhe metodat e tyre për prodhimin e inteligjencës, nuk është gjithmonë e lehtë për ta që të ndajnë inteligjencën e tyre me aleatët. Ndonjëherë kjo është për shkak të shqetësimeve të sigurisë, ndonjëherë për kërkesat e brendshme procedurale dhe ndonjëherë për kufizime teknologjike. Objektivi i ISR-së së përbashkët të NATO-s është të mbrojë konceptin e “nevojës për të ndarë” mbi konceptin “nevoja për të ditur”. Kjo nuk do të thotë që të gjithë aleatët do të ndajnë automatikisht gjithçka, por përkundrazi që NATO mund të lehtësojë

procedurat dhe teknologjinë për të promovuar ndarjen, duke ofruar njëkohësisht sigurimin e informacionit (d.m.th. mbrojtjen e të dhënave dhe rrjeteve). Në këtë mënyrë, aleatët mund të kenë një pamje tërësore të çfarëdo krize që po ndodh dhe vendimmarrësit e NATO-s mund të marrin vendime të mirë informuara, në kohë dhe të sakta.

Mekanizmat

Përvoja që Aleanca fitoi nga operacionet e saj në Afganistan dhe Libi ka rezultuar që asetet e grumbullimit (për shembull pajisjet e grumbullimit të informacionit si avionët e vëzhgimit) të bëhen shumë më të aksesueshme për personelin ushtarak, madje edhe në nivelet më të ulëta taktike. Asetet që do të ishin përdorur vetëm për qëllime strategjike sipas gjykimit të gjeneralëve ushtarakë vite më parë, tani janë gjerësisht të disponueshme dhe përdorimi i tyre është i decentralizuar. Ky ndryshim ndodhi sepse vendet anëtare të NATO-s prokuruan një numër të konsiderueshëm mjetesh grumbulluese detare, tokësore, ajrore, kibernetike ose hapësinore për t'i ndihmuar ata të lokalizojnë kundërshtarët, të cilët shpesh veprojnë në mjedise komplekse dhe midis popullatave civile.

Për të mundësuar mbledhjen e informacionit dhe për të siguruar që informacioni të analizohet dhe të prodhohet inteligjencë për vendimmarrësit, ka një sërë aktorësh kryesorë të përfshirë, duke përfshirë:

Asetet e grumbullimit të vëzhgimit dhe zbulimit

Roli i tyre është mbledhja e informacionit. Shembujt përfshijnë aeroplanët e mbikëqyrjes së Aleancës Tokësore (AGS) dhe Sistemit të Paralajmërimit dhe Kontrollit Ajror (AWACS), të cilët përdorin radarë, satelitë vëzhgimi, mjete elektronike dhe trupa speciale të zbulimit tokësor për të mbledhur informacion.

Analistët e inteligjencës

Roli i tyre është të shfrytëzojnë dhe analizojnë informacionin nga burime të shumta. Shembujt përfshijnë analistët ushtarakë dhe civilë kombëtarë që punojnë në nivel strategjik në organizatat e inteligjencës, analistët e imazheve në të gjitha nivelet dhe ekspertët e enkriptimit.

Vendimmarrësit

Roli i tyre është të përdorin inteligjencën për të informuar vendimmarrjen e tyre. Shembujt përfshijnë liderët politikë dhe komandantët ushtarakë.

Aleanca gjithashtu ushtron rregullisht aftësitë e saj të Përbashkëta të Inteligjencës, Mbikëqyrjes dhe Zbulimit. Në qershor 2020, NATO zhvilloi ngjarjen Unified Vision. Me mbi 250 pjesëmarrës nga 12 vende të NATO-s dhe sisteme të shumta të inteligjencës në hapësirë, në ajër, në tokë dhe në det, ngjarja i lejoi aleatët të shkëmbejnë dhe analizojnë sasi të mëdha të të dhënave të inteligjencës në një mjedis operacional. Ngjarja tjetër e Unified Vision është planifikuar për vitin 2023.

Roli i hapësirës në JISR

Asetet e bazuara në hapësirë, të tilla si satelitët, luajnë një rol kritik në ofrimin e aftësive të inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit për aleatët dhe partnerët e NATO-s.

Pushtimi rus i Ukrainës ka nënvizuar nevojën që Aleanca të ketë një pasqyrë të qartë të të gjitha zhvillimeve në terren, në ajër dhe në det. Fusha hapësinore i ofron NATO-s një avantazh të inteligjencës dhe i lejon aleatët të mbledhin njohuri duke reduktuar dobësitë (d.m.th. duke zëvendësuar nevojën për asete në terren).

Vitet e fundit kanë parë gjithashtu një zgjerim të konsiderueshëm të sektorit të inteligjencës tregtare të bazuar në hapësirë. Kjo përfaqëson një rrezik dhe një mundësi për Aleancën. Përhapja e aktorëve privatë në hapësirë rrit rrezikun e aktiviteteve ISR të kryera nga kundërshtarët e mundshëm kundër popullsisë, territorit dhe forcave aleate. Por aktorët tregtarë mund të ofrojnë zgjidhje me kosto efektive dhe të shkallëzueshme që plotësojnë kërkesat e NATO-s dhe plotësojnë aftësitë në pronësi publike, duke reduktuar varësinë nga një numër i kufizuar i aseteve kombëtare hapësinore.

Në takimin e Ministrave të Mbrojtjes në shkurt 2023, një grup aleatësh të NATO-s së bashku me ish-të ftuarit Finlandën dhe Suedinë (tani vende anëtare të NATO-s) njoftuan synimin e tyre për të nisur iniciativën e Aleancës për Mbikëqyrjen e Përhershme nga Hapësira (APSS). APSS planifikon të ofrojë aftësi të rritura ISR duke përdorur të dhëna nga një plejadë virtuale në shkallë të gjerë satelitësh të vëzhgimit kombëtar dhe komercial, të quajtur “Aquila”. Ky mekanizëm i ri do t'i sigurojë Aleancës inteligjencë më të shpejtë dhe më të mirë, do të integrojë edhe më shumë të dhëna të bazuara në hapësirë në ekosistemin e inteligjencës së NATO-s dhe do të shfrytëzojë përparimet teknologjike nga sektori tregtar.

Evolucioni

Bazuar në përvojën e ftuar nga Aleatët e NATO-s në operacionet e fundit, Aleanca ka krijuar një sistem të përhershëm dhe efektiv të ISR. NATO synon t'u sigurojë aleatëve një mekanizëm që bashkon të dhënat dhe informacionin e mbledhur përmes sistemit AGS ose avionëve AWACS, si dhe një shumëllojshmëri të gjerë të aftësive kombëtare ISR, duke përfshirë trupat në tokë, asetet detare dhe ajrore, platformat me bazë hapësinore si p.sh. si satelitë dhe Forcat e Operacioneve Speciale.

Për të siguruar një bazë për ambicien e përbashkët ISR të NATO-s, Aleanca ka zhvilluar një aftësi JISR që synon të sigurojë shtyllat e mëposhtme:

Trajnimi dhe edukimi

Personeli i përfshirë me aftësinë e përbashkët ISR në NATO do të ketë ekspertizë për të garantuar efikasitetin e ndërmarrjes JISR. Kjo fushë e projektit shqyrton mënyrat për të siguruar që personeli i NATO-s të marrë standardin më të lartë të trajnimit dhe edukimit ISR.

Doktrina dhe procedura

Për të përmirësuar ndërveprimin, efikasitetin, koherencën dhe efektivitetin, doktrina dhe procedurat e përbashkëta të ISR-së do të zhvillohen dhe rishikohen vazhdimisht, nga të menduarit strategjik te procedurat taktike.

Mjedisi i rrjetit

Sistemet e komunikimit dhe informacionit të NATO-s (CIS) do të garantojnë bashkëpunim dhe ndarje efikase të të dhënave, produkteve dhe aplikacioneve ISR ndërmjet Aleatëve. Ky është biznesi kryesor i përpjekjes së përbashkët të ISR të NATO-s.

Gjatë Samiit të NATO-s të vitit 2012 në Çikago, krerët e shteteve dhe qeverive aleate shprehën ambicien për t'i siguruar NATO-s një aftësi JISR të qëndrueshme dhe të disponueshme përgjithmonë, duke i dhënë Aleancës sytë dhe veshët që i nevojiten për të arritur avantazhin e vendimeve strategjike. Duke pasur parasysh mjedisin e sotëm të sigurisë që ndryshon me shpejtësi, JISR vazhdon të përshtatet për të siguruar që Aleanca të ketë informacionin dhe inteligjencën e nevojshme për të marrë vendimet e duhura në kohën e duhur.

Të jesh grua si.....

Formacionet e para ushtarake të përbëra vetëm nga femra, në Europë u krijuan rreth viteve 1900. Formacioni i parë u krijua në Rusi gjatë Luftës së parë botërore (1917): ishte batalioni femëror i vdekjes – në foto – dhe përbëhej nga gra që vetë-ofrohen për të luftuar në vijën e parë të frontit.



Por në të kaluarën e afërt dhe të largët nuk kanë munguar raste të luftëtareve që zbrisnin në fushën e betejës për të mbrojtur popullin e tyre. Në qoftë se historia e femrave amazone është një mit i ushqyer me shumë mundësi nga disa luftëtare ‘shiite’ të cilat luftonin mbi kuaj, janë më tepër se legjendare historitë e grave dhe mbretëreshave të cilat kanë rrokur armët në emër të një ideali ose për të mbrojtur kufijtë e territorit të tyre. Ja disa nga luftëtarët më të famshme të historisë:

Mikesha e persëve – Artemisia (Shek.VI-V p.e.s.) ishte mbretëreshë e Halikarnas-it, një qendër e vogël në Azinë e Vogël. Gjatë luftës së dytë persiane u vendos përkrah persëve, të cilët luftonin kundër grekëve. Sipas Herodotit (484-430 p.e.s.), mbretëresha Artemisia mori pjesë në betejën e Salaminës (480 p.e.s.), dhe kur situata në fushën e betejës ishte në favor të grekëve dhe duke kuptuar se nuk kishte më mundësi fitoreje ia doli të mbijetojë falë një strategjie origjinale: urdhëroi marinarët të ndryshojnë simbolet dhe veshjet të njëjta me simbolet e flotës greke. Me mbarimin e betejës vazhdon të interesohej për fatet e luftës. Mbreti i mbretërve Serse u konsultua shumë herë me të dhe si shpërblim i dha një anije greke.



Hakmarrësja – Tomiri (Shek. VI p.e.s.), mbretëresha e Massageti, u bë e famshme për fitoren dhe vrasjen e perandorit pers Kiri i Madh (530 p.e.s.), kur ai sulmoi vendin e saj për ta pushtuar. Shpirti i saj i copëtuar u bë legjendar: për t'u hakmarrë për vdekjen e të birit, i cili u vra nga Kiri i Madh në dyluftim, pasi e vrau perandorin pers, ia zhyti kokën në një lëkurë dhie të mbushur me gjak dhe më pas ia këputi. Sipas disa gojëdhënave e mbajti kafkën e perandorit gjithë jetën e saj, duke e përdorur si kupë për të pirë verë.



Më e hekurta anti-romake – Budika (33-60 e.r.) ishte mbretëresha e tribusë së ikenëve (Anglinë Lindore). Në periudhën që romakët ishin duke luftuar për pushtimin e Britanisë (43-84 para Krishtit), Budika udhëhoqi revoltën më të madhe të tribuve të ishullit kundër tyre. Dione Cassio (Shek. II) e përshkruan si një grua me “sy të hekurt dhe me zë të vrazhdë”. Sipas tregimtarëve thuhet që ka qenë shtatëllatë dhe shumë e bukur. Me origjinë aristokrate, në moshën 7-vjeçare e dërguan në një familje tjetër, ku ajo u rrit me traditat kelte dhe më pas u martua me mbretin e tribusë së fuqishme të ikenëve. Pas vdekjes së mbretit, romakët pushtuan



mbretërinë e tyre, duke e poshtëruar dhe Budikën publikisht. Në vitin 60 udhëhoqi një revoltë anti-romake, e cila kulmoi me betejën e Watling Street. E detyruar të dorëzohej ajo bëri vetëvrasje.

Mbretëresha e Palmirës - Ksenia - Ksenobia (Shek. III e.r.) mbretëreshë e mbretërisë së Palmirës (qyteti antik që u shkatërrua nga ISIS) ishte një mbretëreshë krenare anti-romake. Mbretëria e saj në momentin e zgjerimit më të madh shkonte nga Siria deri në kufij me Egjiptin. Mbretëresha synonte të zgjeronte territoret e saj në të gjithë Azinë e Vogël. Në vitin 270 kërkoi të arrinte një marrëveshje me perandorin romak Aureliano për të konsoliduar kufijtë e territoreve nën mbretërinë e saj. Por si përgjigje Aureliano bëri një kundërofensivë, duke e mundur në Emesa në vitin 272 e.r. Pas rrethimit të Palmirës, ndërkohë që tentonte të largohej për në Persi u zu rob: por Aureliano i falë jetën dhe e dërgoi në Romë, duke i bërë dhe shëtitjen si trofe lufte.



Çupëlina e Orléans – Zhan D’Ark (1412-31) jetoi përgjatë periudhës së luftës njëqindvjeçare (1337-1453), ku në konflikt ishin dy kombe që po lindnin, Franca dhe Anglia. Me origjinë jo fisnike, në moshën 17-vjeçare, kishte bindjen në vetvete se ishte përzgjedhur nga Zoti për të shpëtuar Francën dhe pasi përshkoi 2000 km dhe mbërriti në oborrin e Karlit të Shtatë dhe kërkoi të kalëronte në krye të ushtrisë që shkonte në ndihmë të Orléans, e rrethuar nga ushtria e Enrikut VI. Pasi mori konsensusin e mbretit çupëlina dhe ushtria e saj ia dolën të çlirojnë Orléans. Por karriera e saj u ndërpre shumë shpejt. Pasi e kapën një vit më pas në një kurth, iu dorëzua Mbretit të Luksemburgut, i cili ia dhuroi si trofe lufte anglezëve. Në vitin 1431, në moshën 19-vjeçare, u akuzua për hermetizëm dhe u dogj e gjallë. Zhan D’Ark është shenjtëruar nga Franca.



Mbretëresha e Forli – Caterina Sforza (1463-1509), vajza e Galeazzo Maria Sforza dhe nëna e Giovanni dalle Bande Nere, qeverisi mbi provincën e Imola dhe Forli. E mbiquajtur Tigreshë për kurajën dhe vendosmërinë e saj, u mor vetë në mënyrë direkte për mbrojtjen e shtetit të saj: planifikonte manovrat ushtarake, për nevojat e



ushtrisë, armët dhe kuajt si dhe stërvitjen ushtarake. Por kjo nuk mjaftoi që të arrinte të ruante territoret e saj nga pushtimet e famëkeqit Cesare Borgia, i mbiquajtur il Valentino. U burgos në Romë, pasi rifitoi lirinë, jetoi vitet e fundit të jetës së saj në Firence.

Grua samurai - Nakano Takeko (1847-68) ishte onna-bugeisha, pra një grua luftëtare, e cila i përkiste aristokracisë japoneze. Këto gra mund të merrnin pjesë në betejë, së bashku me meshkujt samuraj dhe ishin të stërvitura në përdorimin e armëve për të mbrojtur shtëpinë e tyre, familjen dhe nderin në kohë lufte. Nakano Takeko u vendos në krye të një trupe speciale të përbërë nga gra luftëtare, një lloj ushtrie femërore e cila lufton me një shpatë japoneze naginata. Vdiq në fushën e betejës së Aizu (1868), në kulmin e Luftës civile japoneze.



Luftëtare dhe shkrimtare - Nadežda Andreevna Durova (1783-1866), bija e një komandanti huzar, u rrit ndërmjet kalorësve. Mbese dhe nga ky fakt ajo mendoi që nuk do të bënte një jetë prej shtëpiakeje, por do të ndiqte karrierën ushtarake. Kështu që ajo u regjistrua me një emër mashkullor në trupën e Ulaneve, ushtarë kalorës të pajisur me heshta dhe përgjatë betejave napoleonike fitoi disa medalje ushtarake. E apasionuar pas letërsisë publikoi kujtimet e saj në revistën “Sovremennik” (1836) me një prezantim të poetit rus Pushkin.



Luftëtare dhe shkrimtare - Asia Ramazan Asia Ramazan (1996-2014), një luftëtare kurdë, e cila kërkoi të ndalonte avancimin e ISIS në territoret e Kurdistanit sirian. Në 2014, vetëm 18 vjeç, u bë vullnetare e radhëve të Ypj, milicisë femërore kurde, pjesë e milicisë së Kurdistanit sirian. U bë e famshme në mediat perëndimore si simbol i heroinës rezistues dhe nga bukuria si “Angelina Jolie kurde”. Ajo vdiq në vitin 2016 në një betejë në Minbic, Siria e Veriut.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Familja e edukoi me dashurinë për atdheun

Familja e heroinës në origjinë ka jetuar në varfëri të tejskajshme, por gjithnjë ka ruajtur frymën e shëndoshë dhe dashurinë për atdheun. Babai i saj, Isufi, gjatë jetës provoi punët më të rënda si punëtor krahu në ndërmarrjen Rruga-Ura, si emigrant në Greqi dhe në Francë. Me ndjenjë përgjegjësie ndaj atdheut Isufi ka marrë pjesë në luftimet kundër andartëve grekë gjatë viteve 1913-1914; kundër garnizonit italian për çlirimin e qytetit Tepelenë. Si përkrahës i qeverisë së Fan Nolit, Isufi ka marrë pjesë në betejat e Urës së Brarit, në Shkallën e Tujanit dhe si antizogist ka marrë pjesë në Kryengritjen e Fierit të vitit 1935 etj. Ndërsa gjatë LANÇ-it si anëtar i çetës territoriale ka luftuar në disa betejat, si ajo tek Ura e Dragotit, në Shkallën e Zezë, te Ura e Leklit, në Mogila të Vasjarit, Qafa e Miricës, në Dukaj etj. Edhe dy xhaxhallarë të heroinës kanë kryer detyra si veprimtarë aktivë me organet e pushtetit gjatë LANÇ-it. Mamaja e saj, nënë Fatimeja, ka nga trugu i familjes së saj tre dëshmorë të atdheut. Ajo kur mori lajmin për vrasjen e vajzës në luftë, kërkoi me këmbëngulje të shkonte në front e ta zëvendësonte të bijën, por autoritetet e pushtetit vendor nuk e lejuan për arsye moshe, shëndeti dhe kujdestari familjare.

Nimete Progonati, pasi përfundoi arsimin fillor në fshatin Luzat, vazhdoi me këmbëngulje mësimet në shkollën Plotore në qytetin e Tepelenës. Edhe pse në fëmijëri heroina njohu varfërinë migjeniane, në shkollë u dallua për inteligjencë e zell në mësimet. Me prirjen e saj poetike vajza 15-vjeçare ka lënë një fond të vogël me poezi, kryesisht me përmbajtje patriotike, të cilat janë edhe sot një mesazh i fortë atdhetarie për brezat e rinj. Dhe dëshira që ajo u ka shfaqur shoqeve të moshës dhe të afërmeve të saj, ishte që në jetë të bëhej mësuese. Shpesh në shkollë dhe në veprimtaritë që kryheshin i pëlqente të recitonte vargjet e Vaso Pashës: “O moj Shqipni, e mjera Shqipni”. Si debatikase, ka shkruar mësuesi i saj Murat Koçiu, në demonstratën e bukës që u zhvillua më 15 shkurt 1942 në Tepelenë, Nimetja, ish-nxënëse e shkollës plotore recitoi para pjesëmarrësve vjershën “Liria”. Ajo me duart e saj të njoma kontribuoi e thuri për partizanët triko leshi, fanella, çorape, qepte yje, shpërndante trakte e komunikata dhe në disa raste iu besuan detyra për të ruajtur shokët kur zhvilloheshin mbledhje me rëndësi, ndaj të cilave ishte e përgjegjshme dhe i plotësonte me shumë korrektësi.

Luftëtare e lirisë

Nimete Isuf Progonati lindi në Luzat të Tepelenës, më 26 korrik 1929, në një familje atdhetare e patriotë, ardhur në Luzat, më 1805, nga Progonati. Babai i saj, Isufi, ka qenë emigrant në Greqi dhe në Francë dhe me kthimin nga emigrimi punoi punëtor mirëmbajtjeje në ndërmarrjen Rruga Ura. Nimetes që në fëmijëri, nënë Fatimeja bashkë me qumështin, i mëkoi dhe ndjenjën e lirisë e dashurisë për atdheun. Ajo mbaroi shkollën fillore në fshat, ku u dallua si nxënëse e shumë e mirë. Si shumë bashkëmoshatarë, ajo e kishte ndërjet shtypjen, shfrytëzimin, vuajtjen dhe varfërinë që ekzistonte në fshat e më gjerë në krahinën e Labërisë.

Pushtimin fashist e priti me hidhërim, zemërim dhe urrejtje të madhe bashkë me të gjithë moshatarët. Luzati, më 22 dhjetor 1942, bëri betimin si fshat dhe u lidh me LANÇ-in, ku mori pjesë gjithë fshati: burra, gra dhe fëmijë, e midis tyre dhe Nimetia 14 vjeçare. Në Luzat u formua KANÇ i fshatit me kryetar Fuat Shehun, organizata e gruas antifashiste me kryetare Rakibe Qelin dhe organizata e rinisë me sekretar Kamber Qibinin. Nimetia u dallua midis shoqeve e shokëve të organizatës së rinisë së fshatit në kryerjen e detyrave që i ngarkoheshin. Kur mbushi moshën 14 vjeçe, prindërit e fejuan, por ajo nuk e pranoi, theu zakonet e vjetra dhe paragjykimet e kohës.

Nimetia së bashku me tre shoqe të saj, Qibro Gjyli, Tefta Shehu dhe Dylbie Kopaçi, kur në fshat erdhën partizanët e çetës “Ismali Kaso”, kërkuan të shkonin partizane, por komandanti i çetës Fejzo Ismaili iu tha se, kur të vinin herën tjetër do t’i merrnin, por ata nuk u kthyen më në fshat. Një ditë kaluan forcat e BrVS dhe Nimetja së bashku me tre shoqet u futën në përbërje të kësaj brigade dhe marshuan në drejtim të Përmetit. Më 8 prill 1943, ajo me tre shoqet e saj nisën jetën partizane. Ja si i thotë ajo komandantit të çetës “Kështu dukem e parritur dhe disi e imtë nga varfëria e thellë familjare, por jam më e rritur dhe zemrën e kam zjarr, kështu që kam besim se do të duroj çdo vështirësi, çdo zheg në behar, dimër e acar”.

Pushka e Nimetes u dëgjua nga Përmeti, ku u zhvilluan luftime të ashpër në Biovizhd e Çarshovë, ku ajo u dallua për guxim e trimëri. Më 11 maj, komandanti BrVS, Shefqet Peçi, Hero i Popullit, i dhuroi një automatik dhe e quajti “Zhan d’Arka” shqiptare, ndërsa komandanti i BrIS, Mehmet Shehu, Hero i Popullit, e ngriti lart dhe tha: “Me trimëresha si Nimete Progonati,

Nimete Progonati

“Zhan d’Arka” shqiptare

*Nimete Progonati
(Në 80-vjetorin e rënies)*

atdheun do ta çlirojmë me çdo kusht, ajo është shqiptonja e maleve të trimërisë shqiptare”.

Në çdo betejë Nimetja tregonte trimëri e guxim, komandanti i kompanisë Metani nuk i linte vajzat që të dilnin në vijën e parë, me qëllim që t’i ruante, por ajo fshehurazi lëvizte dhe dilte në vijën e parë të luftimeve. Kur komandanti i diktonte, e qortonte ashpër që të ruante veten, por ajo i thoshte se “unë kam ardhur vullnetare partizane që të luftoj kundër armikut, që ka pushtuar vendin dhe jo të bëj sehir, se si luftojnë të tjerët”. Më pas ajo u nis si shqiptonjë në vijën e parë të luftimeve, hapi zjarr të fuqishëm, por një plumb e goditi në gjoksin e saj të njomë, automatiku heshti, iu afruan shokët ajo në grahmat e fundit u thotë: “Merreni automatikun tim se u duhet shokëve”. Pushoi automatiku i Nimetes pushoi dhe zemra e saj e re. Ishte mëngjesi i datës 26 korrik 1944.

Ka mbetur në kujtimet e partizanëve

Dhe më pas, kur u krijua BrVS me Komandant Shefqet Peçin dhe Komisar Hysni Kapon, Nimetja u inkadrua partizane e kësaj njësie luftarake. Vitet e fëmijërisë, heroinën e vogël e mbushën me urrejtje për regjimin e kohës, për pushtuesit italianë dhe më pas edhe për nazistët hitlerianë, por brenda shpirtit të vogëlushes kishte shumë dashuri e optimizëm për jetën. Fryma e shëndoshë patriotike e familjes së saj, ndikimi i mësuesve patriotë dhe mjedisi që e rrethonte në shkollë e kudo, si dhe propaganda e madhe që zhvilloi partia komuniste dhe udhëheqësit e saj për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj e tradhtarët në shërbim të tyre, Nimetes i ndriçuan mendjen, i rritën koshiençën e idealin dhe e poqën ideologjikisht para kohe vajzën 14-15 vjeçare. Në ndërgjegjen e heroinës u rrit e u kalit më shumë ndjenja e përgjegjësisë dhe dashuria për fatet e popullit, jeta e të cilit për shekuj me radhë është histori e pandërprerë luftërash për mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit kombëtar dhe për të mos u asimiluar kurrë.

Pjesëmarrja në Luftën Nacionalçlirimtare, heroinën e vogël, më të voglën vajzë në gjithë atë armatë të ushtrisë çlirimtare, e kaliti dhe e bëri më veprimtare e energjike. Ajo mori pjesë në çdo betejë dhe kudo luftoi me trimëri. Partizanëve që nuk dinin shkrim e këndim heroina në kohën e lirë iu bë mësuesja e tyre, gjithashtu shkroi poezi dhe zhvilloi veprimtari kulturore. Në frontin e luftimit dhe në çdo aksion e reja komuniste Nimete Progonati me thirrjen: “Para partizanë”, në vijë të parë e ballë përballë armikut ngriti lart moralin e shokëve për fitore dhe mbolli panik e frikë në radhët e armikut. Pushka e heroinës që ishte më e gjatë se shtati i partizanes trime, shtiu pa pushim mbi armiqtë e tradhtarët, oshtima e saj u dëgjua fuqishëm prej Lumit të Vlorës, në malet e Kurveleshit, në Çajup, për mbrojtjen e punimeve të Kongresit të Përmetit; në

Qafën e Gjarprit, Gurin e Prerë, Zalosnjë e Mëlovë, Godolesh të Elbasanit, Shupal e Tujan në Tiranë, Burgajet e Macukull, të Burrelit e deri në Sinjë të Dibrës, ku në betejën e përgjakshme të 26 korrikut 1944, Nimete Progonati zuri rob një ballist. Për këtë akt plumb në gjoksin e njomë, ku afirmoi pavdekësinë e kurorëzuar më pas me titullin e lartë të nderit “Heroinë e Popullit”.

Veteranët e LANÇ-it Xhemal Murataj, Levend Lila dhe Ethem Kambo në kujtimet e tyre tregojnë se në betejën e Çarshovës, më 9-11 maj 1944, Nimete Progonati zuri rob një ballist. Për këtë akt trimërie komandanti i Brigadës, gjeneral Shefqet Peçi e falënderoi partizanen para njësies luftarake dhe e krahasoi me figurën e heroinës franceze Zhan d’Ark dhe, si shpërblim për aktin e kryer i dhuruan një automatik anglez dhe dy granata dore. Partizania Nimete Progonati ishte bërë një personazh sa e njohur në gjithë brigadën partizane po aq edhe dashur për shkak të moshës fare të re, për shkathtësinë, energjitë dhe trimërinë e rrallë që tregoi nga njëra betejë në tjetrën deri sa, më 26 korrik 1944, në betejën e Dibrës, heroina dha jetën për lirinë e Shqipërisë. Vdekja vetëm hidhërim shpreh, por humbja e jetës së partizanes trime, ditën që do të festonte me shokët 15 pranverat, u ndje thellë në zemrat dhe në sytë e çdo partizani e partizaneje. Lotët s’i kurseu askush, midis tyre edhe komandanti e komisar i njësies. “Sot, - tha komisar, - humbëm një luftëtare, një trimëreshë, një vajzë që nuk iu tremb vdekjes, poeteshën e vogël, këngëtareshën e mirë, vajzën hokatare, që në kohën e lirë na argëtonte, na çlodhte, na zbaviste dhe na bënte për të qeshur. Nderim për jetën e saj njomëzake”.

Përjetësia e heroinës

Partizanes së vogël si kujtdo që bie në luftë iu bënë nderimet e duhura. Për heroinën është shkruar nga shumë personalitete, figura kuadrosh e veteranë, ish-pjesëmarrës në LANÇ.

Nimete Progonati mban shumë tituj nderi, si: “Heroinë e Popullit” me dekret nr. 5212, datë 21.11.1974, medaljen e “Trimërisë”, të “Çlirimit”, të “Kujtimit”; Është shpallur “Dëshmor i Atdheut” vendim nr. 44, datë 3.8.1971 të Komitetit Ekzekutiv të Tepelenës; Në vendin e rënies, në Sinjë të Dibrës është ngritur një lapidar; Mban emrin e saj shkolla 9-vjeçare e fshatit Sinjë, Dibër; Mban emrin e saj shkolla 9-vjeçare e qytetit Memaliaj; Mban emrin e saj edhe Qendra e Edukimit të Fëmijëve (ish-Shtëpia e Pionierit Tepelenë); Në qendër të qytetit Tepelenë, në bulevardin kryesor, më 11 janar 2001, u përrua busti i Nimete Progonatit, i realizuar nga Artisti i Popullit nga Mumtaz Dhrami.

Për heroinën 15-vjeçare janë botuar shumë shkrime, kujtime, portrete, tregime, poezi, këngë dhe dokumentarë televizivë, të cilët e nderojnë më së miri jetën dhe veprimtarinë e saj.

Zbulimi i artefaktit 3800-vjeçar i përmendur në tregimin biblik

Arkeologët kanë zbuluar një artefakt të rrallë që gjendet në të gjithë Testamentin e Vjetër të Biblës.

Ata zbuluan një tekstil 3800-vjeçar të ngjyrosur me ‘krimbin e kuq’, një ngjyrë që përmendet 25 herë në shkrimet e shenjta, në një shpellë në Izrael.

Boja e kuqe u krijua nga trupat e pajetë dhe vezët e një insekti, të cilat njerëzit i bluanin në një fuqi për të ngjyrosur rrobat.

Tekstili përmbante fije leshi të lyera me ngjyrë të kuqe, të cilat ishin thurur nëpër fije liri pa ngjyrë për të formuar një dizajn të ngjashëm me rrjetë.

Autoriteti i Antikiteteve të Izraelit (IAA) njoftoi gjetjet të enjten, pasi gjeti tekstilin më pak se dy centimetra të fshehur në ‘Shpellën e Kafkave’ në shkretëtirën e Judesë.

‘Krimbi i kuq’ i përmendur në Bibël është një insekt me luspa, i cili jeton në lisa, me speciet kryesore të botës së lashtë Kermes. Femrat dhe vezët e tyre prodhojnë acid karminik, i cili i jep ngjyrës së kuqe pigmentin.

Njerëzit mbledhnin insektet, i spërkatin me uthull, i thanin mbetjet dhe më pas i bluanin në një pluhur që përdoret për të ngjyrosur rrobat dhe tekstilet.

Ngjyrimi i kuq, duke filluar nga portokallia në rozë dhe të kuq, ka pasur simbolikë dhe rëndësi të domethënëse historike, tha ekipi i studimit të publikuar në “Journal of Archaeological Science”.


“Ngjyra e kuqe nga insekte të tilla, të cilat bazohen në molekula si acidi kermesik ose acidi karminik janë të qëndrueshme dhe të bukura, duke i bërë ato shumë më prestigjioze se burimet e ngjyrave vegjetale”.



Boja e kuqe e ndezur njihet si ‘shani’ ose ‘tola’at’ shani në hebraisht (që do të thotë krimb i kuq) dhe është paraqitur në të gjithë Testamentin e Vjetër qoftë vetëm ose së bashku me ngjyra të tjera të çmuara, duke përfshirë ngjyrat blu dhe vjollcë nga kërmijtë detarë.

Te “Levitiku” 14:16 thuhet: “Sa për zogun e gjallë, ai do ta marrë atë, drurin e kedrit, skarlatin dhe hisopin, dhe do t’i zhytë ato dhe zogun e gjallë në gjakun e zogut të vrapimit gjatë vrapimit në ujë”.

Ngjyra e kuqe e thellë përmendet gjithashtu te “Eksodi” disa herë, veçanërisht në kapitullin 26, vargu 1: “Bëni tempullin me dhjetë perde prej liri të përdredhur imët dhe fije blu, vjollcë dhe



Tekstili përmbante fije leshi të lyera me ngjyrë të kuqe, të cilat ishin thurur përmes fijeve prej liri pa ngjyrë për të formuar një dizajn të ngjashëm me rrjetë

flakë të kuqe, me kerubinë të endura në to nga një punëtor i aftë”.

Përdorimi i ‘kermes’ (bojës së krimbit) përmendet edhe në papirusin e Stokholmit, i cili përmban 154 receta për lyerjen e gurëve të çmuar, pastrimin e perlave dhe imitimim të arit dhe argjendit. Dorëshkrimi daton midis viteve 200 dhe 100 para Krishtit. Boja e kuqe e krimbit përmendet gjithashtu në dokumentet e lashta tregtare, si në pllakat kuneiforme nga Mesopotamia, që datojnë në 1425 para Krishtit.

Ekipi zbuloi tekstilin e lashtë në Izrael, duke gjetur një material me bazë bimore nga Levanti jugor, që u përdor për të bërë fijet dhe fijet e indeve ishin të modeluara nga leshi.

“Ky tekstil është një copë me pamje si pëlhurë, me afërsisht 50 fije për cm në sistemin e indeve dhe 10 fije për cm në thurje”, thuhet në studim.

Fijet e indeve janë të rregulluara fort, ndërsa fijet e thurjes janë të vendosura më larg.

Ekipi gjeti disa tekstile të lashta në shpellë, por vetëm një ishte lyer me ngjyrën biblike

Fijet e indeve shfaqnin një ngjyrë të kuqe të theksuar, e cila thurej midis fijeve të pa ngjyrosura.

Studiuesit përcaktuan ngjyrat duke përdorur metodën e analizës së kromatografisë së lëngshme me performancë të lartë (HPLC), e cila ndan përbërësit e tretur në një mostër të lëngshme për të identifikuar përbërësit në përzierje. Ata më pas i krahasuan gjetjet me një bazë të dhënash që përmban standarde me përbërës kimikë të njohur, duke zbuluar acidin kermesik që sekretohet nga insektet.

Tekstili u datua në epokën e mesme të bronzit (1767-1954 p.e.s.) duke përdorur analizën e karbonit-14.

Dr. Naama Sukenik nga IAA tha: “Kjo metodë e avancuar analitike na mundësoi të përcaktojmë origjinën e bojës deri në speciet e sakta të insekteve. Kështu, ne mund të përcaktojmë me probabilitet të lartë se në kohët e lashta, tekstili është ngjyrosur duke përdorur një lloj ‘vermilio Kermes’, i cili prodhon acid kermesik, duke dhënë nuancën e kuqe dalluese”.

Profesor Zohar Amar i Universitetit “Bar-Ilan” tha: “Termi ‘krimb’ në kohët e lashta ishte një term i përgjithshëm për insektet e ndryshme dhe fazat e tyre të zhvillimit.

Lidhja biblike e kësaj ngjyre me një krijesë të gjallë demonstroi njohuri mbresëlënëse zoologjike, duke pasur parasysh se insekteve femërore u mungojnë këmbët dhe krahët, deri në atë masë sa disa natyralistë grekë dhe romakë i ngatërruan ato me kokrriza bimore”. Gjatë historisë, lloje të ndryshme të këtyre insekteve janë përdorur për të prodhuar ngjyrë të kuqe.

Deri më sot, në Amerikën e Jugut, një tjetër specie e insekteve të llojit kokineal, e cila jeton në lloje të caktuara kaktusesh, përdoret për ngjyrosjen e tekstileve.

Pavarësisht nga pasuria e dëshmimeve të shkruara historike për përdorimin e gjerë të ngjyrosjes me insekte me luspa në botën e lashtë, deri më sot, në mbarë botën janë gjetur shumë pak tekstile të ngjyrosura me bëjë prej insekteve, që i paraprijnë periudhës romake.

“Zbulimi i rëndësishëm lidh hendekun midis burimeve të shkruara dhe zbulimeve arkeologjike, duke ofruar prova se industria e lashtë e ngjyrosjes së tekstilit ishte mjaftueshëm e zhvilluar për ngjyrosjen duke përdorur kafshët”, - tha Dr. Sukenik.

“Tekstili i rrallë është një dëshmi e rrjeteve të gjera tregtare ndërkombëtare që funksionojnë tashmë në këtë kohë dhe tregon praninë e një shoqërie elitare”.



Autoriteti i Antikiteteve të Izraelit (IAA) njoftoi gjetjet të enjten, pasi gjeti tekstilin më pak se dy centimetra të fshehur në ‘Shpellën e Kafkave’ në shkretëtirën e Judesë.

“Mos i sanksiononi armët kibernetike, sanksiononi mënyrën se si ato përdoren”

Hapësira kibernetike, që përfshin internetin dhe teknologjitë e tjera dixhitale të lidhura, ofron përfitime të jashtëzakonshme, por gjithashtu paraqet rreziqe të konsiderueshme si një fushë ushtarake. Kjo kërkon ekzistencën e rritjes së sigurisë kibernetike dhe diplomacisë kibernetike.

Diskutimi dhe rregullimi i militarizimit të hapësirës kibernetike kanë fituar rëndësi për shkak të përdorimit më të madh në konfliktet moderne. Lufta në Ukrainë është një shembull i një konflikti të hapur ushtarak që ndodh edhe në hapësirën kibernetike.

Historikisht, kontrolli i armëve ka qenë jetik në parandalimin e përshkallëzimit ushtarak. Megjithatë, krijimi i masave të zbatueshme dhe të verifikueshme për kontrollin e armëve kibernetike është sfidues për shkak të natyrës unike të hapësirës kibernetike.

Një analizë e fundit e kryer nga Universiteti Teknik “Darmstadt” nënvizon disa pengesa kryesore:

Cfarë është një ‘armë kibernetike’?

Një sfidë themelore për vendosjen e kontrollit të armëve në hapësirën kibernetike është mungesa e përkufizimeve të qarta dhe uniforme të termave kyç. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi përkufizimi konvencional i një arme nuk lidhet vërtet me karakteristikën e një sulmi kibernetik të përdorur si një “armë kibernetike”.

Armët kibernetike priren të jenë të dhëna dhe njohuri që mund të konceptohen dhe ekzekutohen për të rrezikuar integritetin, disponueshmërinë ose konfidencialitetin e një sistemi IT pa pëlqimin e pronarit.

Kështu, disa ekspertë me të cilët folëm debatuan se koncepti i një arme kibernetike në vetvete nuk ekziston pasi një armë sugjeron një lloj përdorimi kinetik, fizik. Sulmet kibernetike shfrytëzojnë dobësitë në teknologji dhe mund të çojnë në probleme fizike të botës reale, por a do të thotë kjo se shkaktori ishte një ‘armë kibernetike’?

Kjo paqartësi e bën të vështirë përcaktimin e asaj që do të kontrollohej sipas një traktati të armëve kibernetike.

Mjetet dhe teknologjia e sulmeve kibernetike evoluojnë me shpejtësi... Në kohën kur është rënë dakord për një rregullore, teknologjia mund të ketë avancuar përtej fushëveprimit të saj.



rasti me marrëveshjet e kontrollit të armëve për armët tradicionale.

Për më tepër, pa kosto, armët kibernetike mund të përsëriten pafundësisht dhe të shpërndahen në të gjithë botën. Për shembull, duke marrë parasysh kodin, thjesht fshirja e tij nga një pajisje nuk do të thotë se ai është zhdukur vërtet; mund të kishte përfunduar në një sistem rezervë ose diku tjetër në internet.

Kjo përkeqëson sfidat e krijimit të mekanizmave të përshtatshëm të verifikimit, pasi ato do të duhej të ishin jashtëzakonisht ndërhyrëse. Shumë shtete mund të mos jenë të gatshëm të marrin pjesë në një proces verifikimi ndërhyrës, pasi do t'u duhet të japin njohuri për mbrojtjen e tyre kibernetike, me potencialin që këto njohuri të keqpërdoren për të spiunuar dobësitë e tyre. Dikur konsiderohej tepër kompleks, atribuimi tani është gjithnjë e më i realizueshëm dhe mund të shërbejë si bazë për sanksionimin e përdorimit të armëve kibernetike dhe jo të vetë armëve.

Mjetet dhe teknologjia e sulmeve kibernetike evoluojnë me shpejtësi, shpesh duke tejkaluar përpjekjet rregullatore. Deri në kohën kur është rënë dakord për një rregullore, teknologjia mund të ketë avancuar përtej fushëveprimit të saj. Ky evolucion i shpejtë ndërlikon çdo masë rregullimi ose verifikimi bazuar në veçoritë teknike të softuerit.

Për shembull, kodi i një sulmi kibernetik zakonisht bazohet në zhvillimet e vazhdueshme të softuerit që janë përshtatur për objektiva dhe detyra specifike.

Kjo do të thotë se kodi do të ndryshojë dhe do të evoluojë jashtëzakonisht shpejt. Variacioni do të jetë jashtëzakonisht i lartë dhe sulmet kibernetike në të ardhmen do të jenë gjithmonë të ndryshme nga sulmet e kaluara.

Gjithashtu, për shkak të faktorit të përdorimit të dyfishtë dhe faktit që shumica e infrastrukturës së hapësirës kibernetike është në pronësi private, sektori privat do të duhet të përfshihet dhe të angazhohet që kontrolli i armëve të jetë efektiv.

Ne duhet të shkojmë pas vetë akteve të dëmshme

Vullneti politik është vendimtar për vendosjen e masave të kontrollit të armëve. Shtetet, duke njohur vlerën strategjike të mjeteve kibernetike duke ndërtuar aftësitë e tyre në këtë fushë, mund të ngurrojnë të pajtohen me traktatet e reja që kufizojnë avantazhet e tyre të mundshme. Klima aktuale gjeopolitike i ndërlikon më tej përpjekjet për të arritur një marrëveshje të gjerë.

Duke parë literaturën dhe duke folur me ekspertë, masat tradicionale të kontrollit të armëve nuk mund të zbatohen thjesht për armët kibernetike. Në vend të kësaj, fokusi duhet të jetë në ndalimin e veprimeve të caktuara keqdashëse. Kjo qasje lejon marrëveshje që mund të përshtaten me përparimet teknologjike dhe natyrën e përdorimit të dyfishtë të mjeteve kibernetike.

Që nga viti 2015, negociatat ndërkombëtare në kuadër të Kombeve të Bashkuara (OKB) kanë çuar në vendosjen e 11 normave për sjelljen e përgjegjshme të shtetit në hapësirën kibernetike, duke synuar kufizimin e veprimeve shtetërore dhe përcaktimin e detyrimeve pozitive. Megjithatë, këto norma janë vullnetare dhe jo detyruese, duke çuar në shkelje të shpeshta. Sfida është që këto norma të bëhen më të detyrueshme dhe t'i mbajnë shtetet përgjegjëse për veprimet keqdashëse.

Atribuimi, procesi i caktimit (publikisht) të operacioneve kibernetike aktorëve të veçantë bazuar në prova, është një mjet vendimtar në këtë drejtim. Dikur konsiderohej tepër kompleks, atribuimi tani është gjithnjë e më i realizueshëm dhe mund të shërbejë si bazë për sanksionimin e përdorimit të armëve kibernetike dhe jo të vetë armëve.

Prandaj, kjo duhet të merret si një pikënisje për gjetjen e alternativave kreative dhe zgjidhjeve për kontrollin e armëve në kuptimin tradicional. Pra, konsideratat në drejtim të një mekanizmi ndërkombëtar apo institucionalizimit të proceseve të tilla po rezultojnë të jenë interesante.



Kjo foto e siguruar nga Autoriteti Komunal i Ujit të Aliquippa-s, tregon ekranin e një pajisjeje “Unitronics” që u hakerua në Aliquippa, më 25 nëntor 2023

Shumë teknologji të përditshme, si kompjuterët dhe USB-të, kanë aplikime civile dhe ushtarake.

Nuk mund të vihet asnjë vijë përfundimtare midis këtyre skenarëve të ndryshëm të përdorimit; prandaj, produktet nuk mund të ndalohen në terma themelorë për kontrollin e armëve. Ne mund të ndalojmë minat tokësore ose armët bërthamore, por nuk mund të ndalojmë USB-të ose kompjuterët.

Ndërsa përdorimi i dyfishtë ka luajtur një rol në traktatet e kontrollit të armëve në të kaluarën, natyra e përdorimit të dyfishtë të armëve kibernetike merr një dimension krejtësisht të ndryshëm nga ai i mëparshëm.

Verifikimi për kontrollin e armëve, një nga pengesat më të mëdha

Gjetja e mekanizmave të përshtatshëm të verifikimit për të vendosur kontrollin e armëve në hapësirën kibernetike është jashtëzakonisht e vështirë. Për shembull, për armët kibernetike, nuk është e mundur të përcaktohen sasia e tyre. Dhe ne nuk mund të numërojmë armët apo të ndalojmë një kategori të tërë, siç ka qenë



Adresa në Twitter i përket Phineas Fisher, një haker që mori përgjegjësinë për shkeljen e bashkimit të Mossos d'Esquadra, policia rajonale e Katalonjës, janar 2017

Konferenca e Londrës, 111 vjet nga ndarja e trojeve shqiptare

Konferenca e ambasadorëve në Londër, mbajtur, më 1912-1913, dhe njohur ndryshe edhe si “Konferenca e Paqes në Londër”, ishte një takim ndërkombëtar i gjashtë Fuqive të Mëdha të asaj kohe; Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria, Rusia dhe Italia. Këto fuqi u mbledhën në dhjetor 1912, si pasojë e sukseseve të ushtrive të Ligës Ballkanike kundër Perandorisë Osmane në Luftën e Parë Ballkanike. Në veçanti konferenca u përpoq të luante rolin e arbitrit ndërmjet fuqive ndërluftuese për çështjen e shpërndarjes së tokave dhe gjithashtu përcaktoi të ardhmen e Shqipërisë, e cila deklaroi pavarësinë gjatë Luftës së Parë Ballkanike. Konferenca e Londrës u ndoq nga delegatët e vendeve të Ligës ballkanike, përfshirë Perandorinë Osmane dhe Greqinë, e cila nuk kishte nënshkruar armëpushim.

Konferenca filloi punimet në dhjetor 1912 në St James’s Palace nën drejtimin e Sir Edward Grey. Sesionet e tjera të konferencës vazhduan më 16 dhjetor 1912, por u ndërprenë pa ndonjë konkluzion, më 23 janar 1913, kur në Perandorinë Osmane u zhvillua një grusht shteti. Më 30 maj 1913, konferenca kishte rimarrë punimet dhe nënshkroi Traktatin e Londrës, një marrëveshje sipas së cilës Perandoria Osmane hiqte dorë nga të gjitha territoret në perëndim të kufirit Enos-Midia. Pas shumë diskutimesh, më 29 korrik 1913, ambasadorët morën një vendim formal për të njohur Principatën e Shqipërisë si shtet sovran të pavarur nga Perandoria Osmane.

Si rezultat i presionit nga Greqia dhe Serbia konferenca mori vendime që prekën gjysmën e territorit të Shqipërisë së pavarur, të banuar kryesisht nga shqiptarë etnikë dhe rreth 30% e shqiptarëve mbetën larg kufijve të shtetit shqiptar të sapokrijuar. 40 për qind e popullsisë shqiptare u la jashtë kufijve të Principatës së Shqipërisë. Në veçanti Vilajeti i Kosovës iu dha Serbisë dhe Çamëria Greqisë.

Një komision special u ngarkua për të përcaktuar kufirin shqiptaro-grek. Duke qenë i pamundur studimi i hartave etnografike, vendimi që mori konferenca qe mbi argumente strategjike, ekonomike e politike. Ky vendim i dhuroi Greqisë Epirin Jugor, një tokë të banuar historikisht nga shqiptarë etnikë. Edhe pse morën shumë toka të banuar nga shqiptarë, aleatët ballkanikë mbetën të pakënaqur nga kongresi, dhe menjëherë filluan Luftën e Dytë Ballkanike.

Më poshtë shihni hartën e propozimit të qeverisë shqiptare, propozimit të Francës, Rusisë dhe Ligës së krijuar Ballkanike (Bullgaria, Greqia, Serbia dhe Mali i Zi) si dhe vendimin e marrë nga konferenca e ambasadorëve.

Ndërkohë, në Konferencën e Londrës po përfundonte lufta diplomatike për caktimin kufirit shqiptaro-malazez dhe shqiptaro-serb, e ndodhur përballë këmbënguljes së lidhjes trepalëshe. Rusia pranoi që Shkodra më në fund t’i lihej Shqipërisë, me kusht që qeveria e Vjenës të hiqte dorë nga Peja, Prizreni, Gjakova dhe Dibra, duke përfshirë këtu edhe malin e Taraboshit, me Lumën. Për ta zgjidhur këtë çështje, të dy palët u detyruan të bënin lëshime të reja. Diplomacia ruse, në krye me Sazanovin, hoqi dorë nga Taraboshi dhe Luma, ndërsa Bertholdi, i interesuar për Shkodrën, që të mos binte në duar të malazezëve, hoqi dorë nga Peja, Prizreni, Gjakova, dhe krahina e Dibrës, me Tetovë, Gostivar deri në Strugë. Më 26 mars, Eduard Grej, kryetari i Konferencës dhe ambasadorët e Fuqive të Mëdha, të akredituar në oborrin e Shën Xhejmsit (Saint James), në emër të qeverive të tyre, pranuan formalisht përcaktimin e kufijve veriorë dhe verilindorë të Shqipërisë, që ishte miratuar më 22 mars 1913. Me këtë vendim, Shqipërisë Etnike iu shkëputën arbitrarisht nga trugu i saj krahina e Gucisë dhe Plavës, qytetet e rëndësishme të Pejës, Gjakovës, Prizrenit dhe Shkupit, krejt fusha e Kosovës, e banuar me shumicë të madhe nga shqiptarët, si dhe qytetet e Përlepit, Manastirit, Resnjës, Ohrit dhe Strugës, deri në Dibër.

Konferenca e Ambasadorëve vendosi përfundimisht që Shkodra me rrethinën e saj t’i mbetej Shqipërisë, ndërsa Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe pjesët e tjera të trevave lindore, ku bënin pjesë Manastiri, Shkupi Kumanova e Presheva t’i mbeteshin Serbisë dhe Malit të Zi. Pas këtij vendimi pjesëmarrësit e Konferencës kërkuan nga Mali i Zi dhe Serbia që të lëshonin Shkodrën. Me këtë vendim nuk ishte dakord Esat Pasha, i cili veproi ndryshe nga rekomandimet e Konferencës, pasi ai kishte edhe përkrahjen e Rusisë. Në fillim kishte në plan të parë që të niset me ushtrinë e tij kundër Qeverisë së Përkohshme për asgjësimin e saj, pasi kishte edhe përkrahjen e Qeverisë turke. Në këto rrethana, ai vazhdoi të qëndrojë edhe më tutje në Shkodër, por me nënshkrimin e armëpushimit midis Turqisë dhe shteteve Ballkanike, më 16 prill, siguroi përkrahjen nga Mali i Zi për t’u bërë princ i Shqipërisë dhe i jepej mundësia të themelonte një qeveri më vete, që do ta zëvendësonte atë të Vlorës. Kjo ishte një ndër arsyt kryesore që Esat Pasha më në fund nënshkroi tradhtisht marrëveshjen e kapitullimit, më 22 prill 1913. Me ushtrinë e tij turko-shqiptare dhe me plot armatim ai u largua nga qyteti një muaj pas vendimit të Konferencës për copëtimin e Shqipërisë Etnike. Pra pas shtatë muajsh qëndrese dhe mbrojtje të suksesshme, ushtria malazeze pa



luftë e mori Shkodrën. Por, pushtimi malazez nuk pati jetë të gjatë, pasi Konferenca urdhëroi Kral Nikollën që ta lëshojë Shkodrën, të cilën e bëri, më 4 prill, kurse në qytet hynë forcat ndërkombëtare. Administrimi i qytetit kaloi në duar të një Komisioni Ushtarak Ndërkombëtar i kryesuar nga Sesil Burnej. Ky komision nuk lejoi të ngrihej në Shkodër flamuri kombëtar, si dhe nuk e njohu për këtë Qeverinë Provizore të Ismail Qemalit. Komisioni vendosi brenda në qytet marrëdhënie koloniale. Po ashtu në këto rrethana të reja Esat Pasha i frikuar nga invadimi ushtarak austro-italian që kishin lidhur një aleancë të fshehtë për Shqipërinë, më 8 maj 1913, Esati vendosi që me ushtrinë e tij të largohej nga Shqipëria me anijet turke, gjatë muajit qershor për në Turqi. Në këtë kohë Qeveria Xhonturke e Enver Pashës ishte e pashpresë.

Në prill, Qeveria e Enver Beut vendosi të rihapte përsëri Konferencën e Paqes. Këtë herë bisedimet vazhduan deri më 30 maj 1913, kur u nënshkrua Traktati i Londrës, sipas të cilit Turqia përjashtohet përfundimisht nga Evropa. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Sulltani mundi të ruajë vetëm Kostandinopojën dhe një rrip tokësor nga Enosi në Detin Egje, deri në Media në Detin e Zi. Pjesa tjetër e territoreve iu dorëzua vendeve ballkanike. Më 7 prill 1913, Eduart Grej, në raportin e tij të para dhomës së komunave, ndër të tjera tha: “Marrëveshja e Fuqive për të respektuar kufijtë e Shqipërisë u arrit pas përpjekjesh të gjata dhe të lodhshme diplomatike. U vendos që brigjet e liqenit të Shkodrës t’i takojnë Shqipërisë, ndërsa Peja, Prizreni dhe Dibra, si dhe pas shumë përpjekjesh dhe negocimesh, edhe Gjakova të lihej jashtë Shqipërisë. Kjo marrëveshje ishte thelbësore për paqen në Evropë, dhe është arritur pikërisht për të ruajtur paqen midis Fuqive të Mëdha.

Në bazë të gjitha normave ndërkombëtare, kjo ishte tërësisht një padrejtësi e madhe kundër vullnetit të shprehur nga vetë populli shqiptar në Kuvendin e Vlorës. Pra, me këtë vendim arbitrar, ku mbi 55% e tokës shqiptare ndahej ndërmjet Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi, ishte një padrejtësi që iu bë popullit shqiptar, i cili kufizohet nga të gjitha anët me popullin e vet, që nuk i është bërë asnjë shteti tjetër. Një popull kaq liridashës, që ka luftuar pandërprerë për lirinë e vet dhe të fqinjëve të tij që nga koha e Skënderbeut e deri më sot, tani po copëtohej për interesa të shteteve të Ballkanit. Këtë ndarje politike e përshkruan më së miri Edit Durham, e cila thotë:

“Përpjekjet e përbashkëta të Francës dhe të Rusisë e kishin ndarë Shqipërinë gati përgjysmë dhe i kishin caktuar kufijtë në mënyrën më mizore”.

Në këtë mënyrë për të kënaqur aspiratat e shteteve sllave të Ballkanit, padrejtësisht nga trugu i saj u ndanë qytete dhe krahina të tëra shqiptare, si: Dibra, Peja, Gjakova, Prishtina, Gjilani, Presheva, Bujanovci, Kaçaniku, Shkupi, Kumanova, Manastiri, Struga, Kërçova, Tetova, Gostivari etj.

Me vendimet e 22 marsit, trevat e Shqipërisë Lindore si pjesë përbërëse e Shqipërisë Etnike ndaheshin nga trugu i saj dhe hynin nën sundimin e ri të pushtesit serb. Kundër këtij vendimi të padrejtë të Fuqive të Mëdha u protestua ashpër në të gjitha trevat shqiptare: të Çamërisë, të Dibrës, të Kosovës, të Hotit, të Grudës, të Anamalit dhe të krahinave të tjera që deri në këtë kohë bënin pjesë në hartën e katër vilajeteve të Shqipërisë Etnike. Pra, shqiptarët protestuan kudo u dërguan memorandume, protesta e letra, Fuqive të Mëdha për rishikimin e vendimit të 22 marsit dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare.

Në letërën protestuese, të nënshkruar nga Mehmet pashë Derralla, Isa Boletini dhe Qerim Begolli, dërguar Fuqive të Mëdha thuhej: “Ne nuk kundërshtuam marshimin e aleatëve dhe armatave të tyre për të larguar robëruesin e përbashkët. Por nuk mund të jemi dakord që një popullsi prej një milion shqiptarësh myslimanë e katolikë të bien nën sundimin e ri serb, përqindja e të cilit në këto territore shqiptare nuk arrin mbi 5%. Këtë mund ta verifikoni me dërgimin e një komisioni të lartë evropian”.

Një memorandum tjetër në emër të trevave verilindore drejtuar Bertholdit më 25 janar 1913, nga një grup atdhetarësh nga Italia, ku kërkohet: “Të na njihet e drejta jonë e shenjtë, duke përfshirë në shtetin tonë të gjitha ato vise të cilat për arsye etnike, geografike dhe historike janë tërësisht shqiptare, të cilat pjesë shumë të rëndësishme të vendit tonë janë: Shkodra, Ipeku, Gjakova, Prizreni, Shkupi, Tetova, Prishtina, Dibra, Manastiri, Ohri dhe Janina. Për të cilat kanë pretendime të pabazuara nga shtetet ballkanike, sepse këto territore janë të njohura si tërësisht shqiptare, më 1880 nga Lordi Ficmoris, Goshen, Granvill. Vetëm kështu do të arrihet ekuilibri evropian dhe paqja e qëndrueshme, për ndryshe, duke na shkëputur vetëm njërin nga këto vise nuk do të ketë tjetër veçse çrregullime



të përhershme dhe gjakderdhje”. Po ashtu një memorandum tjetër i paraqiti Konferencës dhe “Forin Ofisit”, delegacioni i Qeverisë së Përkohshme Shqiptare në Londër, në krye me Rasih Dinon, Mehmet Konicën dhe Filip Nogën, ku paraqitej një statistikë e popullsisë së qyteteve të vilajetit të Kosovës, si: Mitrovica, Vuçitërna, Prishtina, Presheva, Gjilani, Kumanova, ku vërtetohej se popullsia këtyre qyteteve mbi 80% janë shqiptarë.

Edhe pse ngjarjet e vitit 1912, në Ballkan dhe Kryengritja Shqiptare patën jehonë të madhe, jo vetëm për njohjen e të drejtave të shqiptarëve në Ballkan, por edhe më gjerë, shqiptarët u tërhoqën nga Shkupi pasi Fuqitë e Mëdha garantuan se do të plotësoheshin kërkesat e shqiptarëve për “autonomi”, duke marrë garanci nga Turqia. Ata me këto “premtime” dhe me plot besim e entuziazëm, duke treguar një kulturë të lartë politike dhe një tolerancë shembullore, duke zbatuar urdhrat e komandantëve të tyre e lëshuan Shkupin, shkuan nëpër shtëpitë e veta, “të bindur në fitoren e autonomisë, ku përfshiheshin 14 pikat e kërkesave të tyre”. Me këto suksese, ata vazhduan të qeverisnin në tërë qytetet e Vilajetit të Kosovës: në Kumanovë, Preshevë, Tetovë, Gostivar, Dibër, Kaçanik, Ferizaj, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë e deri në Novi Pazar etj. Shqiptarët ishin të sigurt në drejtësinë e vendimeve që do të merrnin Fuqitë e Mëdha: “se do të vendosin drejt për zgjidhjen e autonomisë shqiptare dhe të popujve të vegjël në fillim të shekullit XX”.

Me mbarimin e Luftës së Parë Ballkanike, Fuqitë e Mëdha kësaj radhe heshtën përpara kërkesave, memorandumeve dhe protestave të shqiptarëve. Ata vendosën kundër fakteve historike dhe nuk morën parasysh luftën katërvjeçare për pavarësi të popullit shqiptar. Fuqitë e Mëdha në vend të përkrahjes, kësaj radhe vepruan kundër interesave të popullit shqiptar dhe luftës së drejtë të tij. Konferenca e Londrës, në vend që të gjykonte drejt, ajo vendosi që territorin e Shqipërisë etnike, më 22 mars, ta ndante në dy pjesë: një pjesë të ishte e lirë dhe më shumë se gjysma e robëruar nga serbo-malazezët. Territoret nga Liqeni i Ohrit deri në Novi Pazar, territore të banuara me shumicë shqiptare, ku bënëin pjesë 18 qytete shqiptare të Vilajetit të Kosovës, dhe trojeve të tjera lindore, ku bënëin pjesë: Manastiri, Ohri, Struga, Kërçova, Gostivari, krahina e Rekës deri në Dibër iu dhanë Malit të Zi dhe Serbisë.

Për këtë ndarje më së miri do të shprehej Eduard Greji: “Marrëveshja ndërmjet fuqive lidhur me kufijtë V të Shqipërisë u arrit pas përpjekjesh të gjata dhe të vështira diplomatike. U vendos që zona bregdetare dhe Shkodra të jenë shqiptare, kurse Ipeku, Prizreni, Dibra dhe pas shumë negociatash edhe Gjakova të lihej jashtë Shqipërisë. Ky rregullim lë një pjesë të madhe territori për t’u ndarë ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi, si fryt i fitores. Arritja e marrëveshjes ishte thelbësore për paqen në Evropë dhe, sipas mendimit tim, u realizua pikërisht në kohë për të ruajtur paqen midis Fuqive të Mëdha”.

Në të njëjtën kohë delegacioni shqiptar i kryesuar nga Ismail Qemali, Isa Boletini, Luigi Gurakuqi dhe Dhimitër Berati kishte filluar të protestonte në qendrat diplomatike të Evropës, duke kundërshtuar ashpër këtë padrejtësi, ku cungohej territori i Shqipërisë Etnike, nga vendimi që kishin marrë Fuqitë e Mëdha. Anëtar i këtij delegacioni, Isa Boletini, në intervistën e tij të parë që bëri më 10 prill në Vejnë, në një pritje në Ministrinë e Luftës, iu bë kjo pyetje: “Nga cili vend do të kishit dashur një mbret të ardhshëm të Shqipërisë? Isa Boletini iu përgjigj: “Së pari një princ anglez e pastaj gjerman”.

Nga fillimi i muajit maj, delegacioni shqiptarë arriti në Londër. Në intervistën që i dha Isa Boletini gazetës “Daily telegraph”, pasi foli gjatë për luftën 30-vjeçare dhe sakrificat që kishte bërë populli shqiptar për pavarësi në fund tha: “Prandaj kam ardhur në Londër që të protestoj, si përfaqësues i Kosovës dhe si delegat i Qeverisë së Vlorës, që të kërkoj të drejtën nga Evropa”. I pyetur se a do t’i pranonte kufijtë që i ka caktuar Konferenca e Ambasadorëve, ai u përgjigj: “Unë kurrë nuk do t’i pranoj ato kufij që i ka caktuar Evropa dhe derisa të jem gjallë do të luftoj kundër serbëve, malazezëve,

grekëve dhe kundër të gjithë armiqve të Shqipërisë”. Kjo deklaratë e tij u botua edhe në faqen e parë të gazetës serbe “Politika”.

Nga fundi i majit delegacioni shqiptar u largua i pakënaqur nga Londra dhe u kthye në Vlorë. Krerët e Lëvizjes Shqiptare kurrse si nuk mund të pranenin copëtimin e Shqipërisë dhe marrjen e vilajetit të Kosovës nga sunduesit serbë. Dëshpërimi dhe pakënaqësia e udhëheqësve shqiptarë të vilajetit të Kosovës vazhdonte pandërprerë, edhe pse disa prej krerëve kosovarë zunë poste të larta në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës. Ata nuk hoqën dorë kurrë nga Pavarësia e Kosovës dhe trojeve të tjera Lindore si pjesë përbërëse e Shqipërisë Etnike. Në këto rrethana të vështira ministri i parë i Luftës Mehmet pashë Tetova, Isa Boletini dhe Ajdin Draga, i dërguan për herë të dytë telegram protestues qeverive të gjashtë Fuqive të Mëdha të Evropës, ku kërkonin “rishikimin e kufijve të Shqipërisë Etnike”.

Delegacioni shqiptar u bind se edhe Austro–Hungaria nuk donte të prishej me Rusinë dhe me Anglinë për çështjen shqiptare, pasi edhe vetë Bertholdi deklaroi: “Kërkesat e shqiptarëve janë të drejta, por ne nuk mund t’i sigurojmë kufijtë se këto na shpien kah lufta me Rusinë, pasi edhe Franca mbante haptazi anën e Rusisë dhe ishte kundër zgjidhjes së drejtë të çështjes shqiptare, ata mbronin synimet dhe aspiratat serbe kundër Shqipërisë. Në këto rrethana tejet të vështira për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë, është me rëndësi të vihet në dukje se Austro–Hungaria dhe Italia, për realizimin e aspiratave të tyre politike bënë marrëveshje të fshehtë për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Në marrëveshjen e tyre të 8 majit të vitit 1913, dalin në shesh qëllimet e diplomacisë sekrete dhe projekti i Fuqive të Mëdha, të parashtruara në Konferencën e Londrës për ndarjen e Shqipërisë. Ky është një shembull tipik i diplomacisë sekrete evropiane.

Sipas kësaj marrëveshjeje sekrete, në këtë projekt ishte parashikuar që në pjesën Veriore të Shqipërisë të vendosej Austria deri në Lumin Shkumbin, ndërsa në Jug të vendosej pushteti italian. Ky projekt i ashtuquajtur “sekret”, de facto ishte një kopje e marrëveshjes serbo–greke, e nënshkruar gjatë Aleancës Ballkanike ndërmjet Greqisë dhe Serbisë.

Për fatin e shqiptarëve dhe të luftës së tyre të drejtë e të pandërprerë, këto projekte hegjemoniste nuk u realizuan kurrë. Kjo është një dëshmi vetëm për “sinqeritetin” e diplomacive të Fuqive të Mëdha, për “zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare në kufijtë të saj etnikë dhe bashkimin e katër vilajeteve”.

Konferenca e Ambasadorëve i vazhdoi punimet e saj mbi statutin e organizimit të Shqipërisë dhe kufirit jugor të saj. Më 15 qershor 1913, Austro-Hungaria dhe Italia paraqitën përsëri një propozim mbi organizimin e Shqipërisë. Vetëm pas shumë diskutimesh, gjatë të cilave Franca dhe Rusia bënë në vazhdimësi kundërshtime, fuqitë ranë në ujdj, ku Shqipëria, më 29 korrik 1913, u shpall principatë pa asnjë lidhje me Turqinë, ku një Komision Internacional Kontrolli i përbërë prej delegatëve të gjashtë Fuqive të Mëdha do të mbikëqyrte administratën dhe financat e Shqipërisë dhe princi do të caktohej brenda 6 muajve. Pra, Shqipëria më në fund mori formën e Protektoratit, e cila ishte në kundërshtim me kërkesat e popullit shqiptar që ishte në kundërshtim të plotë me sovranitetin e saj.

Kjo njohje gjysmake e një pjesë të Shqipërisë, ishte një akt më i ulët sesa ajo e Kuvendit Kombëtar, të cilën e shpalli Ismail Qemali, më 28 nëntor në Vlorë, prandaj kjo njohje e Shqipërisë nga Fuqitë Mëdha, kur nuk kënaqi aspiratat e popullit shqiptar si shtet neutral nën patronazhin e Fuqive të Mëdha. Qeveria e Përkohshme në krye me Ismail Qemalin, kurrë nuk ra dakord me ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha në punët e brendshme të vendit, që cenonin hapur pavarësinë dhe sovranitetin e Shqipërisë. Kjo qeveri atdhetare kurrë nuk u pajtua as me gjymtimin territorial të Shqipërisë Etnike. Ismail Qemali shpresonte se një ditë do të vinin rrethana më të favorshme për rikthimin e Shqipërisë në kufijtë e saj etnik, pasi ky popull kreshnik ka luftuar pa ndërprerë midis Ballkanit, nga periudha heroike e Skënderbeut e deri më sot për çlirim nacional e bashkim kombëtar: “Një gjuhë, një komb, një shtet”

Qeveria e Vlorës u drejtua për 14 muaj në kushte mjaft të

vështira politike-ekonomike, por ajo kreu “në mënyrë të shkëlqyer detyrat më të rëndësishme historike: siguroi ekzistencën e Shqipërisë së Pavarur; ngriti shtetin e ri shqiptar; përcaktoi qysh në lindje të Shqipërisë një politikë të jashtme të paqes, neutralitetit dhe ekuilibrave në Ballkan; hodhi themelet e arsimit shqiptar; u bë shprehësja e aspiratave të thella të popullit tonë për zhvillime evropiane perëndimore”.

Austro-Hungaria insistoi në Konferencën e Ambasadorëve edhe për një garanci në mbrojtjen dhe lirinë kulturore të shqiptarëve të ngelur nën sundimin e shteteve Ballkanike. Këto propozime ajo ia paraqiti Londrës me anë të ambasadorit të saj, kontit Mensdorff. Propozimet kërkonin një barazi të plotë ligjore dhe kulturore, sepse ne kishim frikë, dhe me të drejtë, që pushtuesit do të përdornin metoda shkombëtarizimi. Mjerisht këto propozime të Austro-Hungarisë nuk kaluan, pasi diplomacia ruse ishte kundër atyre.

Konti Berchtold, pa dyshim, ishte një nga protagonistët më të zjarrit për krijimin e një Shqipërie të lirë. Ky

i mbushur me një entuziazëm të singertë për këtë pikësynim të punës së tij të zorshme dhe këmbëngulëse, ku pati për kundërshtar politikën pan-sllaviste. Ai tek Shqipëria dhe populli shqiptar shihte një shtet që mund të jetonte dhe i vinte keq kur luftohej në Londër për çështjen shqiptare, që nuk kishte një qeveri qendrore dhe unike të Shqipërisë. Derisa vazhdonin bisedimet në Londër, në Shqipëri deri në vitin 1913, u formuan katër qeveri: Qeveria provizore e Vlorës nën Ismail Qemalin, e dyta; Qeveria e Shqipërisë së Mesme me seli në Durrës, e udhëhequr nga Esad pashë Toptani, i cili ishte kundërshtar i fortë politik i Qeverisë së Vlorës dhe mercenar i njohur i Serbisë. Qeveria e tretë, ajo e Ded Çokut në Lezhë dhe e katërta, ishte Qeveria e Prenk Bib Dodës, e shpallur në Mirditë. Vendi paraqiste një tablo të vajtueshme të përçarjeve e ndasive politike.

Këto rrethana të brendshme në Shqipëri, fare nuk favorizuan pozicionin e ministrit të Jashtëm Berchtold, për të mbrojtur integritetin e plotë të Shqipërisë. Ai luftoi vetë me forcat e veta kundër të gjithëve në këtë Konferencë, e cila zgjati mbi gjashtë muaj ku donin ta gllabëronin Shqipërinë nga harta e Ballkanit. Prandaj, sot pas njëqind vjetësh ndajmë mendimin se ishte një sukses i madh i diplomacisë Austro-Hungareze për arsye se u arrit krijimi i një Shqipërie të Pavarur dhe Autonome edhe pse gjysmake.

Faji duhet kërkuar te vetë shqiptarët, pasi në këto çaste nuk shikonin bashkimin dhe mbrojtjen e vendit nga shtetet sllave por vraponin të përfitonin në dëm të popullit për interesa të veta personale. Prandaj, sot nga ajo distancë kohore i japim mirënjohje politikës Austro-Hungareze në krye me diplomatin Berthold. Edhe pse ky luftoi më të gjitha forcat për të mirën e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar në fund nuk mundi t’i kapërcente kundërshtimet e Rusisë dhe Francës për të mbrojtur kufijtë etnikë të shpallur në Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Prandaj, në këto rrethana të reja midis Ballkanit duhej bërë urgjentisht një bashkim midis shqiptarëve, ku aktuale ishte çështja e zgjedhjes së Mbretit për të formuar një qeveri qendrore unike.

Shtetet ballkanike të ndihmuara nga Rusia dhe Franca, ishin shkaktarë kryesorë që penguan popullin shqiptar të kurorëzonte me sukses të plotë luftën katërvjeçare, për ruajtjen e tërësisë territoriale, ku i shkëputën këto treva nga trugu i mëmëdheut. Sunduesit e rinj mbi trojet shqiptare që u vendosën si rezultat i vendimeve të Konferencës së Londrës, filluan menjëherë aplikimin e një politike të egër shtypëse për kolonizimin dhe serbizimin e këtyre viseve. Politika e egër serbe i trajtoi shqiptarët si element i huaj në krahinat e aneksuara, edhe pse ajo e dinte se këto territore denbabaden janë të tyre dhe i kanë poseduar shqiptarët para se ato të vendoseshin në Ballkan. Ajo përdori kundër shqiptarëve metodat më barbare të dhunës e të terrorit. Kjo politikë pan-sllaviste serbe çoi në shtimin e urrejtjes së të gjithë popullatës kundër sunduesit të ri. Populli shqiptar dhe krerët e saj ishin të vendosur të luftonin deri në fund kundër regjimit të egër të pushtuesve serbë. Pra, në këto rrethana filloi një fazë e re e luftës kundër sunduesve të rinj, lufta për çlirim kombëtar dhe bashkim me shtetin amë, luftë kjo që vazhdon sot e kësaj dite.

Shqiptarët e trevave lindore kurrë nuk u pajtuan me këtë vendim arbitrar, prandaj në vitin 1919, i dërgojnë një Memorandum kryetarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Wilson, që të korrigjojë këtë padrejtësi të bërë kundrejt popullit shqiptar dhe Shqipërisë Etnike të ndarë në dy pjesë, më 22 mars 1913. Memorandumi drejtuar kryetarit Wilson fillon me fjalët e Ptolomeut ku përmend i pari shqiptarët në këto territore që janë raca më e vjetër që ndodhen në Evropë. Me shpalljen e Pavarësisë nga Ismail Qemali një muaj më pas Fuqitë Mëdha e njohën independencën e Shqipërisë të shpallur, më 28 Nëntor 1912, në Kuvendin kombëtar të Vlorës. Por, pas tre muajsh njohjeje u soll një vendim tjetër arbitrar, ku gjysma e Shqipërisë ngeli e robëruar nën sundimin greko-serbo-malazez.



FORCAT E ARMATOSURA **KANË HAPUR REGJISTRIMET PËR:**

→ *Ushtar / Detar aktiv*

afati: 26 gusht 2024

→ *Kursi për Përgatitjen e Oficerit në
Akademinë e Forcave të Armatosura*

afati: 23 gusht 2024